



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 135

Tiranë – E premte, 22 korrik 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 8.6.2016	Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore..... 10565
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 13.7.2016	Për një ndryshim në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, të ndryshuar..... 10568
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 513, datë 13.7.2016	Për pjesëmarrjen e një toge këmbësorie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, me mision, në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndhmës në Herat, në kuadër të operacionit të NATO-s “RSM”, Afganistan..... 10569
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 515, datë 13.7.2016	Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2017–2019..... 10570
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 516, datë 13.7.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 10573
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 517, datë 13.7.2016	Për miratimin e raportit të monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2015..... 10573
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 13.7.2016	Për disa ndryshime në vendimin nr. 55, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Ndhmës Shtetërore”, të ndryshuar..... 10584
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 519, datë 13.7.2016	Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike..... 10585
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 13.7.2016	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, të ndryshuar..... 10594

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 521, datë 13.7.2016	Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Ermira Bakalli (Garunja).....	10597
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 522, datë 13.7.2016	Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Sistemi i menaxhimit të kartelave informative për shërbimet publike”.....	10597
Urdhër i inspektorit të përgjithshëm të Inspektoratit Qendror nr. 32/1, datë 14.7.2016	Për disa shtesa dhe ndryshime me urdhrin nr. 32, datë 29.4.2014, “Për miratimin e modelit të kartës së inspektorit”.....	10598
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Veteran Nevrus Avxhi.....	10600

**VENDIM****Nr. 438, datë 8.6.2016****PËR KRITERET DHE RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT TË PYJEVE DHE TË SHITJES SË MATERIALIT DRUSOR E TË PRODHIMEVE TË TJERA PYJORE E JOPYJORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 27, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të pikës 10, të nenit 26, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të neneve 3, pika 1, shkronjat “a” e “c”, dhe 4, të ligjit nr.5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. OBJEKTI DHE QËLLIMI**

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i kriterëve dhe rregullave të shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore, me qëllim plotësimin e nevojave të popullatës me dru zjarri dhe shëndetësimin e pyjeve, pa cenuar rregullat e vendosura nga ligji nr. 5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”.

II. PËRKUFIZIME

Për qëllim të këtij vendimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Rigjenerim”, procesi i sigurimit të gjeneratës së re të pyllit, i cili sigurohet në rrugë natyrale dhe/ose nëpërmjet ndërhyrjes me shfrytëzim selektiv (të përzgjedhur) të pyllit. Rigjenerimi dhe format e tij janë kriterë bazë për përcaktimin e definicionit (përkufizimit) mbi origjinën e një pylli;

“Shëndetësim/prerje sanitare”, procesi i trajtimit të pyllit nëpërmjet ndërhyrjeve me metoda teknike, duke eliminuar drurët, të cilët shfaqin shenja të dëmtimit (natyral dhe/ose artificial, të prekur nga sëmundje dhe/ose të dëmtuar për shkaqe natyrore) dhe duke garantuar vijimësinë e grumbullit, nëpërmjet drurëve të shëndetshëm.

III. KRITERET E SHFRYTËZIMIT DHE PROCEDURA

1. Trajtimi dhe shfrytëzimi i fondit pyjor publik/privat, me qëllim sigurimin e nevojave për ngrohje të banorëve të bashkive, rigjenerimin dhe shëndetësimin e pyjeve mbështetet në të dhënat e

planeve të mbarështimit dhe inventarizimit të tyre dhe ka si bazë ngastrat e nënngastrat pyjore. Shfrytëzimi i fondit pyjor për këtë qëllim përmblledh ndërhyrjet dhe trajtimet silvikulturore në moshën e shfrytëzimit dhe kur është siguruar ripërtëritja natyrore.

2. Materiali drusor, që shfrytëzohet çdo vit nga fondi pyjor publik dhe privat, caktohet brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit e të trajtimit të pyjeve në ngastrat dhe nënngastrat, të përcaktuara në planet e mbarështimit apo inventarizimit.

3. Pas miratimit të sasisë së shfrytëzimit, struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki miraton projektin tekniko-ekonomik të trajtimit apo shfrytëzimit të pyjeve, për të cilat garantohet zhvillimi i qëndrueshëm, efektiviteti ekonomik, mirëadministrimi dhe ruajtja e asortimentit dru zjarri.

4. Sasia e shfrytëzimit vjetor, pavarësisht nga nevojat e popullsisë për ngrohje, caktohet brenda mundësisë vjetore të shfrytëzimit, të përcaktuar në planet e mbarështimit të pyjeve shtetërore dhe privat, si dhe nga materiali drusor që rezulton nga realizimi i përmirësimeve pyjore nëpërmjet investimeve.

5. Shfrytëzimi i fondit pyjor kombëtar organizohet mbi bazën e vitit pyjor, i cili fillon më 1 tetor dhe përfundon në 30 shtator të vitit pasardhës.

6. Bashkitë, brenda datës 30 prill të çdo viti, pasi vlerësojnë nevojat e komunitetit dhe enteve të tjera publike për dru zjarri, pa tejkalluar mundësinë e shfrytëzimit të pyjeve shtetërore dhe private, dërgojnë për miratim, në drejtorinë përkatëse, në Ministrinë e Mjedisit, kapacitetin dhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit.

7. Ministri i Mjedisit, me urdhër të veçantë, miraton për çdo vit pyjor mundësinë vjetore të shfrytëzimit të pyjeve shtetërore dhe të pronarëve privatë për secilën bashki.

8. Shfrytëzimi dhe trajtimi i pyjeve nga bashkitë për sigurimin e nevojave për ngrohje, nxjerrja dhe magazinimi i tyre në sheshet e depozitimit, të përcaktuara paraprakisht, realizohet nga:

a) subjekte të licencuara, të kontraktuara nga bashkia, në bazë të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, me objekt prerjen e materialit drusor në këmbë (të paprerë) dhe transportin e tyre;



b) ndërmarrjet e specializuara, të ngritura pranë bashkisë.

9. Subjektet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 8, përpara fillimit të shfrytëzimit duhet të pajisen me kopje kontrate, me procesverbal dorëzimi të ngastrave/nënngastrave, leje shfrytëzimi dhe vërtetim transporti.

10. Në çdo rast, struktura përgjegjëse për administrimin e pyjeve dhe kullotave në bashki i njofton degës së ISHMP-së kopjen e kontratës së lidhur, sipas shkronjës “a”, të pikës 8, dhe/ose aktin e miratimit të shfrytëzimit të ndërmarrjes së specializuar, të ngritur pranë bashkisë, sipas shkronjës “b”, të pikës 8.

11. Sasia e lëndës drusore së prerë, sipas pikës 8 më sipër, i dorëzohet bashkisë, e cila, më pas, e magazinon dhe e administron atë, sipas planifikimeve të miratuara paraprakisht nga drejtoria përkatëse, në Ministrinë e Mjedisit.

12. Pas marrjes në dorëzim të materialit drusor nga bashkia, shitja e tij në pikat e depozitimit bëhet sipas tarifave të përcaktuara në vendimin nr. 391, datë 21.3.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

13. Transporti i lëndës drusore bëhet pas markimit me mënyrën dhe ngjyrën përkatëse, të miratuar nga bashkia, dhe shoqërohet me faturë dhe vërtetim transporti, sipas formatit dhe përmbajtjes së miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit.

14. Prodhimi i vërtetimeve të transportit, administrimi i tyre dhe pajisja e lëndës drusore me to kryhet nga bashkia.

15. Caktimi i ngastrave për t’u përshkuar me prerje ripërtëritëse/rigjeneruese, shënimi i drurëve me damkë dhe matja e tyre, përpilimi i listëdamkave, hartimi i projektit teknologjik dhe tekniko-ekonomik të trajtimeve për secilën ngastër pyjore, për prodhimin e druve të zjarrit, bëhet deri më 30 korrik të çdo viti.

16. Prerja e drurëve pyjorë në fondin pyjor kombëtar bëhet pas shënimit të tyre me damkë të veçantë nga specialistët e lartë të pyjeve (dega silvikulturë, i përgjithshëm, mbarështim-shfrytëzim). Shënimi i drurëve me damkë, si rregull, fillon mbas datës 15 maj dhe përfundon në datën 15 korrik.

17. Në pyjet trungishte prerja lejohet gjatë gjithë vitit, kurse në pyjet cungishte dhe shkurret, të cilat

ripërtërihen me lastarë, lejohet nga 1 tetori deri në 31 mars të vitit pasardhës. Në rastet e vegjetacionit të vonuar, struktura përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki zgjat periudhën e prerjes deri në 15 prill, për zonat fushore, dhe deri në 30 prill, për zonat malore.

18. Me miratimin paraprak të ministrit, mbështetur në legjislacionin në fuqi për prokurimet ose me anë të ndërmarrjes së saj të specializuar, bashkia realizon pastrimin e mbeturinave drusore. Në raste të tilla, bashkia, nëpërmjet strukturave përgjegjëse për pyjet dhe/ose personave të licencuar, harton një studim mbi sasinë, cilësinë, kostot e përfitimet financiare dhe vendndodhjen e mbeturinave dhe e paraqet atë për miratim në Ministrinë e Mjedisit.

IV. CAKTIMI, DORËZIMI PËR SHFRYTËZIM I NGASTRAVE DHE NËNNGASTRAVE PYJORE

19. Para se të fillojë shfrytëzimin, subjekti i kontraktuar apo vetë ndërmarrja e specializuar e bashkisë kontrollon në vend ngastrën/nënngastrën dhe i paraqet me shkrim strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki vërejtjet për vëllimin drusor. Me urdhër të kryetarit të bashkisë ngrihet komisioni që verifikon vërejtjet dhe, kur ato qëndrojnë, ai urdhëron strukturën përgjegjëse për pyjet dhe kullotat pranë bashkisë të bëjnë ndryshimet përkatëse.

20. Dorëzimi i ngastrës bëhet me pjesë të subjekti i kontraktuar, me procesverbal, dhe pas dorëzimit të kësaj pjese, struktura përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në bashki, bën procesverbalin e kolaudit provizor të saj. E njëjta procedurë vijohet edhe me pjesët e tjera, deri në kolaudimin përfundimtar të ngastrës/nënngastrës.

21. Deri në momentin e dorëzimit dhe kolaudit përfundimtar të ngastrës/nënngastrës, ajo mbrohet nga dëmtimet dhe zjarret nga subjekti i kontraktuar apo nga ndërmarrja e specializuar, kur është kjo vetë duke e shfrytëzuar.

22. Kolaudit provizorë dhe ai përfundimtar bëhen nga struktura përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave në bashki, në prani të drejtuesit teknik të subjektit ose ndërmarrjes së specializuar të bashkisë.

V. RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT

23. Subjekti i kontraktuar apo ndërmarrja e specializuar e bashkisë zbaton rregullat dhe kërkesat teknike, metodikat e procedurat për



shfrytëzimin e ngastrave/nënngastrave, të cilat specifikohen në kontratën e lidhur mes palëve, si dhe zbaton kërkesat e skemës teknologjike të shfrytëzimit.

24. Struktura përgjegjëse për pyjet e kullotat në bashki monitoron mënyrën e shfrytëzimit dhe nxjerrjen e materialit drusor dhe, në rastin kur vëren shkelje, ndërhyr, duke kërkuar riparimin e tyre.

25. Me përfundimin e plotë të prerjes e nxjerrjes së materialit drusor dhe pas pastrimit të ngastrës/nënngastrës, subjekti ia dorëzon ngastrën/nënngastrën strukturës përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki.

26. Sigurimi i druve të zjarrit për ngrohje, nga banorët e fshatrave malore dhe në brendësi të pyjeve, kryhet edhe nëpërmjet mbledhjes (vlerësimit) të materialit drusor nga drurët e rrëzuar (shkulur e thyer) nga furtunat e zjarret dhe punimet e trajtimit rigjeneruese të pyllit, me rrallime e prerje sanitare e shëndetësimi, sipas projekteve të hartuara dhe vlerësimit paraprak në vëllim të materialit drusor. Projektet e hartuara miratohen nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Trajtimit të Pyjeve në Ministrinë e Mjedisit. Për plotësimin e nevojave të familjeve hartohet lista, në bazë fshati, nga administratorët e njësive bashkiake, miratohet nga drejtoria e shërbimit pyjor në bashki dhe, pas pagesës, sipas tarifave përkatëse në fuqi, bëhet plotësimi i nevojave.

VI. SHITJA E MATERIALIT DRUSOR

27. Shitja e materialit drusor të pyjeve publike, me qëllim ngrohjen e popullsisë, bëhet vetëm nga bashkitë, drejtpërsëdrejti të popullata apo enti shtetëror, ndërkohë që transporti i lëndës drusore për ngrohje mund të realizohet nëpërmjet të kontraktuarit të saj, nga venddepozitimi deri në destinacionin e blerësit.

28. Shitjes i nënshtrohet dhe materiali drusor i sekuestruar. Në këtë rast, procesverbali i sekuestrimit është pjesë e dokumentacionit të shitjes.

29. Në rast se nga shfrytëzimi i pyjeve publike të territorit të një bashkie ka tepriçë prodhimi të materialit drusor, pas plotësimit të nevojave të banorëve të saj dhe enteve të tjera publike, që veprojnë në të, bashkia këtë tepriçë ua shet bashkive të tjera të vendit, referuar kërkesës së këtyre të fundit.

VII. KONTRATAT EKZISTUESE PËR SHFRYTËZIMIN E FONDIT PYJOR PUBLIK /PRIVAT

30. Subjektet që kanë fituar me ankand të drejtën e shfrytëzimit të ngastrave/grup-ngastrave, me dhe pa rrugë autopsyore, dhe kanë ende kontrata të vlefshme me Ministrinë e Mjedisit apo drejtoritë e shërbimit pyjor, kanë të drejtën e shfrytëzimit të tyre deri në prerjet përfundimtare, pas rinegociimit të tyre me bashkinë, në territorin administrativ të së cilës ndodhet objekti i kontratës, në funksion të shkronjave “a” e “c”, të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr.5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”. Shfrytëzimi i ngastrave/grup-ngastrave bëhet vetëm me qëllim shëndetësimin e pyjeve, pastrimin e mbeturinave dhe për plotësimin e nevojave të banorëve të bashkive dhe enteve të tjera për dru zjarri.

31. Koha e pezullimit të kontratave, që nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, dhe deri në rinegociimin, për pasojë rilidhjen e tyre me bashkitë, do të shtyjë afatin e përfundimit të kontratës ekzistuese për aq kohë sa është periudha e ndërprerjes (pezullimit).

32. Këstet e pagesës sipas kontratave, të lidhura me Ministrinë e Mjedisit dhe me ish-drejtoritë e shërbimit pyjor, të cilat nuk janë likuiduar pas hyrjes në fuqi të ligjit të moratoriumit, likuidohen menjëherë pas lidhjes së kontratave të rinegociuara me bashkitë, në llogaritë bankare të këtyre të fundit.

VIII. RREGULLAT E SHFRYTËZIMIT DHE TË SHITJES SË PRODUKTEVE JO-PYJORE

33. Grumbullimi nga pylli i prodhimeve të dyta pyjore, si rrënjë shqope, mareje, bushi etj. dhe i boçave të pishës realizohet nga bashkia, me anë të një subjekti të licencuar, të kontraktuar, referuar legjislacionit në fuqi për ankandet publike.

34. Përpara shpalljes së procedurës së ankandit, bashkia harton dhe miraton projektin tekniko-ekonomik që do t'i nënshtrohet procedurës së konkurrimit.

35. Subjektet e përcaktuara në pikën 29, më sipër, përpara fillimit të shfrytëzimit duhet të pajisen me kopje kontrate, me procesverbal dorëzimi të ngastrave/nënngastrave, leje shfrytëzimi dhe vërtetim transporti.



36. Në raste emergjente, dëmtimesh nga katastrofat natyrore e zjarret, pavarësisht moshës së pyjeve, bashkia zhvillon edhe ankande të tjera, pas miratimit me urdhër të ministrit të Mjedisit.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

37. Planifikimi i mundësisë vjetore të shfrytëzimit të pyjeve, damkimi i drurëve pyjorë dhe trajtimi e shfrytëzimi i pyjeve në të gjitha fazat realizohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për pyjet dhe atij për inspektimin dhe janë objekt i inspektimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve.

38. Në rastet kur bashkia nuk i plotëson nevojat e komunitetit të saj me lëndë drusore, ajo gëzon të drejtën e plotësimit të tyre nga fondi pyjor privat, sipas dispozitave ligjore të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, por procesi i shfrytëzimit të këtij fondi, deri në shitjen e produktit të komuniteti apo entet e tjera, realizohet nga bashkia, sipas përcaktimeve të pikës 8, të këtij vendimi.

39. Dokumentacioni teknik për shfrytëzimin e pyjeve dhe formati i tij është i unifikuar. Ai hartohet nga Ministria e Mjedisit, miratohet me urdhër të ministrit dhe u njoftohet bashkive brenda 30 ditë, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

40. Vendimi nr. 394, datë 21.6.2006, i Këshillit të Ministrave, “Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe shitjes së materialit drusor e prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore”, të ndryshuar, dhe vendimi nr. 22, datë 9.1.2008, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

41. Ngarkohen Ministria e Mjedisit dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

X. DISPOZITA KALIMTARE

42. Në rastet e mungesës së planeve të mbarështimit dhe inventarizimit të pyjeve, përpara miratimit të mundësisë vjetore të shfrytëzimit për vitin 2016, strukturat përgjegjëse për pyjet dhe kullotat në bashki të rishikojnë planin e mbarështimit dhe inventarizimit që disponojnë ose hartojnë studime pjesore për ngastrat që do të shfrytëzohen.

43. Vlerësimi e dërgimi për miratim i nevojave të komunitetit dhe enteve të tjera publike për dru zjarri, nga ana e bashkisë, në përputhje me pikën 6 të këtij vendimi, vetëm për vitin 2016, do të

realizohet brenda datës 30 korrik 2016.

44. Caktimi i ngastrave për t’u përshkuar me prerje ripërtëritëse/rigjeneruese, shënimi i drurëve me damkë dhe matja e tyre, përpilimi i listdamkave, hartimi i projektit teknologjik dhe tekniko-ekonomik i trajtimeve për secilën ngastër pyjore, për prodhimin e druve të zjarrit, në përputhje me pikën 15, të këtij vendimi, vetëm për vitin 2016, do të realizohet brenda datës 15 shtator 2016.

45. Shënimi i drurëve me damkë, përpara prerjes së tyre, në përputhje me pikën 16, të këtij vendimi, vetëm për vitin 2016, do të realizohet brenda datës 15 shtator 2016.

46. Subjektet, të cilat, referuar aktverifikimeve të lëshuara nga Inspektorati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve, zotërojnë lëndë drusore të prerë përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 5/2016, “Për shpalljen e moratoriumit në pyje në Republikën e Shqipërisë”, si dhe ata që do të zotërojnë lëndë drusore të prerë në zbatim të kontratave të rinogociuara dhe rilidhura, në përputhje me pikën 30 të këtij vendimi, pajisen me vërtetim transporti, referuar pikës 14 të këtij vendimi, vetëm për qëllim të shëndetësimit të pyjeve, pastrimit të mbeturinave dhe të furnizimit me dru zjarri.

47. Shfrytëzimi dhe trajtimi i pyjeve nga bashkitë, për vitin 2016, me qëllim sigurimin e nevojave për ngrohje, realizohet nga subjekte të licencuara, të kontraktuara nga bashkia, në bazë të legjislacionit në fuqi për ankandet me objekt prerjen e materialit drusor në këmbë (të paprerë), transportin dhe shitjen e tyre të bashkitë, entet publike dhe konsumatorët familjarë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM Nr. 512, datë 13.7.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat



kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në listën e shkronjës “C”, “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”, çregjistrohet individ i renditur në shkronjën “a”, në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues të organizatës ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

(LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN ISIL (Da’esh) dhe AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën ISIL (Da’esh) dhe Al-Qaida”;

1. DANIEL; MARTIN; SCHNEIDER.

Shënim. Gjeneralitetet e tjera për personin emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahet në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

VENDIM

Nr. 513, datë 13.7.2016

PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE KËMBËSORIE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME MISION, NË KOMANDËN E TRAJNIM-KËSHILLIMIT DHE NDIHMËS NË HERAT, NË KUADËR TË OPERACIONIT TË NATO-s “RSM”, AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, dhe 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr.64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin, me mision, të një toge këmbësorie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 40 (dyzet) ushtarakë, pranë Komandës së Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, Afganistan.

2. Misioni i togës është ruajtje baze (*force protection*) në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, në kuadër të operacionit të NATO-s “RSM”, në Afganistan.

3. Toga nuk mund të përdoret për detyra të tjera, përveç ruajtjes, brenda perimetrit, të bazës ushtarake të Komandës së Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, Afganistan.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 4 (katër) vjet, afat, i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të kontingjentit të parë në Afganistan. Periudha e qëndrimit në mision, për çdo kontingjent, do të jetë me sistem rotacioni në çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik).

5. Venddislokimi i kësaj toge do të jetë në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në Herat, Afganistan.



6. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerje disipline;

ë) aktivitete social-kulturore, në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarrëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Transportimi i personelit, që do të shërbejë në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria, transportimi i individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe, ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

8. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

10. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 515, datë 13.7.2016

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE
PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE
TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2017–2019

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 23, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e taveve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2017–2019, sipas lidhjes nr. 1, “Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vendimi nr. 230, datë 30.3.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2017–2019”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi



TAVANET E MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE BUXHETORE, NË MILION LEKË

FAZA II		Viti 2017					Viti 2018					Viti 2019							
		600-601	602-606	230-231			600-601	602-606	230-231			600-601	602-606	230-231					
	Emërtimi i institucionit buxhetor	Paga+sig.shoq.	Të tjera korrente	Investime/ të brendshme	Investime/ të huaja	Transferim për fondet speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	Paga+sig.shoq.	Të tjera korrente	Investime/ të brendshme	Investime/ të huaja	Transferime për fondet speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	Paga+sig.shoq.	Të tjera korrente	Investime/ të brendshme	Investime/ të huaja	Transferime për fondet speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali
1	Presidenca	100	87	5	0		192	100	87	6	0		193	100	87	6	0		193
2	Kuvendi	609	452	49	0		1,110	609	452	48	0		1,109	609	452	48	0		1,109
3	Kryeministria	660	1,194	740	704		3,297	660	1,199	754	550		3,162	660	1,199	754	550		3,162
4	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	591	408	451	600		2,050	591	408	324	600		1,923	591	408	324	600		1,923
5	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	1,721	3,245	1,785	2,685		9,437	1,721	3,449	1,880	2,085		9,136	1,721	3,549	1,880	2,085		9,236
6	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	419	3,182	14,758	14,905		33,264	419	3,182	14,712	16,700		35,013	419	3,182	14,264	17,200		35,065
10	Ministria e Financave	3,354	3,832	510	700		8,396	3,354	3,832	500	700		8,386	3,354	3,832	500	700		8,386
11	Ministria e Arsimit dhe Sportit	24,772	8,196	2,850	500		36,318	24,772	9,256	2,834	500		37,362	25,172	9,896	4,634	500		40,202
12	Ministria e Kulturës	879	384	392	0		1,654	879	384	450	0		1,712	879	384	450	0		1,712
13	Ministria e Shëndetësisë	2,621	2,052	1,060	1,140	26,195	33,067	2,621	3,318	1,075	1,140	26,904	35,058	2,895	3,483	2,075	1,140	27,513	37,105
14	Ministria e Drejtësisë	4,346	1,488	529	300	2,436	9,100	4,346	1,388	530	800	2,862	9,926	4,346	1,388	530	800	3,778	10,842
15	Ministria e Punëve të Jashtme	808	1,436	55	0		2,299	808	1,436	60	0		2,304	808	1,436	60	0		2,304
16	Ministria e Brendshme	14,902	3,765	1,042	400		20,109	15,002	3,775	1,100	400		20,277	15,002	3,775	1,100	400		20,277
17	Ministria e Mbrojtjes	6,366	5,701	1,344	0		13,411	6,366	5,701	1,350	0		13,417	6,366	5,701	1,350	0		13,417
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,010	394	50	0		1,454	1,010	394	50	0		1,454	1,010	394	50	0		1,454
19	Drejtoria e Radio- Televizionit	0	565	0	0		565	0	565	0	0		565	0	565	0	0		565
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	124	33	5	0		162	124	33	5	0		162	124	33	5	0		162
22	Akademia e Shkencës	32	68	2			102	32	68	2			102	32	68	2			102
24	Kontrolli i Lartë i Shtetit	269	91	50	152		562	269	87	20	0		376	269	87	20	0		376
	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	2,465	25,118	619	100	48,489	76,791	2,465	25,118	602	100	51,308	79,593	2,465	25,118	602	100	53,100	81,385
26	Ministria e Mjedisit	750	258	1,610	588		3,206	750	258	1,615	690		3,313	750	258	1,615	690		3,313
28	Prokuroria e Përgjithshme	1,190	339	135	0		1,664	1,190	339	130	75		1,734	1,190	339	130	75		1,734
	Zyra e Administrimit Buxhetit																		
29	Gjyqësor	1,659	351	170	0		2,180	1,659	351	160	0		2,170	1,659	351	160	0		2,170
30	Gjykata Kushtetuese	82	30	4	0		116	82	30	4	0		116	82	30	4	0		116
31	Ajencia Telegrafike Shqiptare	40	15	1	0		56	40	15	1	0		56	40	15	1	0		56
40	Partitë politike	0	200	0	0		200	0	200	0	0		200	0	200	0	0		200
50	Instituti i Statistikës	345	90	7	7		449	345	90	7	0		442	345	90	7	0		442
55	Shkolla e Magistraturës	32	31	1	0		64	32	31	1	0		64	32	31	1	0		64
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,550	4,000		5,550	0	0	1,560	5,300		6,860	0	0	1,560	6,302		7,862
	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	9	146	2			157	9	146	2			157	9	146	2			157
63	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	64	27	2			93	64	27	2			93	64	27	2			93
66	Avokati i Popullit	85	17	4			106	85	17	4			106	85	17	4			106
	Komisioneri për Mbrojtjen e Shërbimit Civil	37	13	4			54	37	13	4			54	37	13	4			54
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	68	632	3			703	68	21	3			92	68	632	3			703
	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave	92	22	3			117	92	22	3			117	92	22	3			117
76	Autoriteti i Konkurrencës	53	10	1			64	53	10	1			64	53	10	1			64
78	Ministria e Integritetit	123	65	38	356		582	123	50	43	220		436	123	50	43	220		436
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	8	4	1	0		13	8	4	1	0		13	8	4	1	0		13
87	Institucione të tjera qeveritare	306	248	101	20		675	306	248	98	20		672	306	248	98	20		672



88	Mbështetje për shoqërinë civile	16	106	1			123	16	106	1			123	16	106	1			123
89	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	44	18	1			63	44	18	1			63	44	18	1			63
91	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	27	10	1			38	27	10	1			38	27	10	1			38
92	Instituti i Studimeve të Krimeve të Komunizmit	18	13	1			32	18	13	1			32	18	13	1			32
93	Ministria e Energjisë dhe Industrisë	450	245	2,082	690		3,467	450	245	1,500	560		2,755	450	245	1,200	560		2,455
94	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit	518	677	1,058	193		2,446	518	677	980	220		2,395	518	706	980	220		2,424
95	Autoriteti për të Drejtën e Informimit	20	0				20	20	0				20	20	0				20

**VENDIM**

Nr. 516, datë 13.7.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR.418, DATË 27.6.2012, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E MASËS SË
SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË
KËSHILLAVE, BORDEVE OSE
KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË
QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 5, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronjat “c” dhe “ç” riformulohen, si më poshtë vijon:

“c) Për Komisionin Rajonal Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dhe për Komisionin Mjekësor Qendror për Përcaktimin e Verbërisë, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, masa e shpërblimit është 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj, për kryetarin, dhe 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj;

ç) Për Komisionin Epror Mjekësor për Caktimin e Aftësisë për Punë, në varësi të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Shërbimit Social Shtetëror, masa e shpërblimit është 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë në muaj, për kryetarin, dhe 20 000 (njëzet mijë) lekë në muaj, për anëtarin, pavarësisht nga numri i mbledhjeve të kryera në një muaj.”.

2. Shkronja “d” shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

VENDIM

Nr. 517, datë 13.7.2016

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË
MONITORIMIT TË NDIHMËS
SHTETËRORE PËR VITIN 2015**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17, shkronja “dh”, 18, shkronja “e”, e 32, pika 2, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2015, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi**

**RAPORTI I MONITORIMIT TË
NDIHMËS SHTETËRORE
PËR VITIN 2015**

1. HYRJE

Raporti vjetor i monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2015 përfshin të gjitha shpenzimet e ndihmës shtetërore në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të nenit 32, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, dhënësit e ndihmës detyrohen që brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesin pranë Drejtorisë së Tregut të Brendshëm, në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, raportin e zbatimit për të gjitha skemat e ndihmës shtetërore dhe ndihmat individuale të dhëna gjatë vitit paraardhës financiar.

Mbi bazën e tyre përgatitet Raporti Vjetor i Ndhimave Shtetërore, i cili miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Të dhënat e përfshira në këtë raport janë raportuar nga dhënës të ndihmës shtetërore: Ministria e Financave (MF), Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHE/TTS), Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (Drejtoria e Përgjithshme e



Ujësjiellës-Kanalizimeve), Ministria e Kulturës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (Shërbimi Kombëtar i Punësimit), Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) dhe Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Shpenzimet e ndihmës shtetërore lidhen me të gjitha masat ekzistuese të ndihmës për sektorin e prodhimit, shërbimeve, bujqësinë dhe peshkimin dhe skemat e reja të ndihmës shtetërore të miratuara nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore gjatë vitit 2015. Në hartimin e Raportit të nëntëvjetor për ndihmat shtetërore, struktura e raportimit të ndihmës shtetërore është bazuar në aneksin III të rregullores “Për procedurat formën e njoftimit”¹, si dhe në metodologjinë e Komisionit Evropian². Në këtë mënyrë në raport jepet informacion për shumën e ndihmës shtetërore në BE dhe shtetet anëtare.

Në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Bashkimin Evropian, neni 71, pika 5, parashikohet se vendi ynë duhet të garantojë transparencë në fushën e ndihmës shtetërore, duke paraqitur raportin vjetor dhe duke ndjekur metodologjinë e Komisionit Evropian për ndihmën shtetërore. Për këtë arsye, ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar, ngarkon strukturat e ndihmës shtetërore³ për përgatitjen e këtij raporti, duke plotësuar një detyrim ligjor dhe duke shënuar një hap përpara në drejtim të angazhimeve, që ka ndërmarrë vendi ynë në fushën e ndihmës shtetërore në kuadër të procesit të integritetit në BE.

Sipas metodologjisë, ndihma shtetërore klasifikohet në dy grupe kryesore:

1. Ndhma shtetërore për bujqësinë dhe peshkimin; dhe

2. Ndhma shtetërore për industrinë dhe shërbimet

Ndhma shtetërore për industrinë dhe shërbimet përfshin kategorinë e ndihmës horizontale dhe ndihmës sektoriale.

Ndhma shtetërore horizontale përfshin:

- ndihmën për kërkim-zhvillim dhe inovacion;

- ndihmën për mbrojtjen e mjedisit;

- ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;

- ndihmën për punësim;

- ndihmën për trajnim;

- ndihmën operacionale;

- ndihmën për sportin;

- ndihmën për kulturën.

Ndhma shtetërore sektoriale përfshin:

- ndihmën për transportin publik;

- ndihmën për shërbimet publike;

- ndihmën për minierat;

- ndihmën për energjinë;

Ndhma shtetërore jepet duke përdorur disa instrumente, si:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2 - Përrjashtimi nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - Instrumente të tjera;

D - Garancitë.

¹ VKM nr. 817, datë 28.12.2005, “Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit”.

² Ligji nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, i ndryshuar.

³ Neni 17 “Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit”, shkronja “f”, dhe neni 18, shkronja “g” “përgatit raportin vjetor”.

2. NDIHMA SHTETËRORE NË VITIN 2015

2.1 Ndhimja shtetërore krahasuar me treguesit kryesorë makroekonomikë

Tabela nr. 1. Ndhimja shtetërore krahasuar me disa nga treguesit makro

Treguesit	Njësia e matjes	2011	2012	2013	2014	2015
Ndhimja Shtetërore	mln euro	117.52	154.56	143.85	44.74	44.50
PBB	mln euro	9,125.07	9,540.94	9,681.00	10,092.00	10,523.34
Ndhimja Shtetërore/PBB	%	1.29	1.62	1.49	0.44	0.42
Shpenzimet nga Buxheti I Shtetit	mln euro	2.679	2,707	2.919	3,257	3,325
Ndhimja shtetërore /Shpenzimet buxheti I shtetit	%	4.4	5.7	4.93	1.37	1.338
Të punësuar	mijë	1,161	1,117	983	1,067	1,087
Ndhimja shtetërore për cdo të punësuar	euro	101	138	146	42	40.94
Popullsia	milion	2.84	2.82	2.89	2.89	2.91
Ndhimja shtetërore për frymë	euro	41	55	50	16	15.3

Burimi: MF, INSTAT dhe MZHETTS


Tabela nr. 1 paraqet të dhënat për ndihmën shtetërore gjithsej, të dhënë në Shqipëri në periudhën 2011–2015, të krahasuara me disa nga treguesit bazë makroekonomikë. Ndhimja shtetërore në vlerë absolute e dhënë në vitin 2015 ka zbritur me 15 % e krahasuar me vitin 2014. Peshë e ndihmës shtetërore ndaj PBB-së zbriti nga 1.49 % në vitin 2013, në 0.44 % në vitin 2014 dhe në 0,42 në vitin 2015.

Ndhimja shtetërore *përfshirë* sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2015 është dhënë në vlerën totale prej 6.166.60 mln lekësh (44,92 mln euro).

Ndhimja shtetërore *përfshirë* sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2015 është dhënë në vlerën totale prej 4.616,99 mln lekësh (33,63 mln euro).

Raporti vjetor përmban të dhëna për periudhën 2011–2015, por Grafiku nr. 1 paraqet ecurinë e ndihmës shtetërore në Shqipëri nga viti 2005 e në vazhdim, periudhë për të cilën janë raportuar të dhënat e ndihmës shtetërore.

Grafiku nr. 1. Ecuria e ndihmës shtetërore në raport me PBB 2005–2015





2.2 Ndhimja shtetërore në Shqipëri e krahasuar me shtetet anëtare të BE-së

Tabela nr. 2. Ndhimja shtetërore 2013–2014

Burimi: Komisioni Evropian, DG Competition⁴ dhe MZHETTS

Shtetet	2013		2014	
	mln euro	% PBB	mln euro	% PBB
Shqipëria	143.85	1.45	46.41	0.44
EU (28 countries)	59,438.60	0.43	93,520.69	0.67
Belgium	1,522.60	0.39	1,606.50	0.40
Bulgaria	46.70	0.11	150.90	0.35
Czech Republic	1,528.60	1.01	2,004.70	1.30
Denmark	2,473.20	0.97	2,426.80	0.94
Germany	12,785.00	0.45	38,537.60	1.32
Estonia	89.80	0.46	201.50	1.01
Ireland	883.40	0.49	541.40	0.29
Greece	2,593.10	1.47	1,668.50	0.94
Spain	2,530.30	0.25	2,666.50	0.26
France	12,420.00	0.58	14,365.00	0.67
Croatia	149.70	0.35	153.90	0.36
Italy	2,757.50	0.17	4,870.20	0.30
Cyprus	82.60	0.46	81.40	0.47
Latvia	334.30	1.45	447.40	1.89
Lithuania	113.80	0.32	78.20	0.21
Luxembourg	131.00	0.28	134.00	0.27
Hungary	1,168.10	1.16	1,451.60	1.39
Malta	130.60	1.70	80.80	1.02
Netherlands	1,631.20	0.25	1,769.60	0.27
Austria	1,688.00	0.51	1,317.40	0.40
Poland	2,232.20	0.56	4,495.10	1.09
Portugal	441.20	0.26	722.40	0.42
Romania	859.00	0.59	848.30	0.57
Slovenia	410.00	1.13	393.90	1.06
Slovakia	180.50	0.24	298.60	0.40
Finland	1,442.70	0.70	1,510.70	0.74
Sweden	3,219.90	0.77	3,167.60	0.74
United Kingdom	5,593.60	0.26	7,530.60	0.33

Tabela nr. 2 paraqet informacion për ndihmën shtetërore në Shqipëri dhe 28 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për vitin 2013 dhe 2014. Në tabelë janë përfshirë të dhënat e publikuara nga Komisioni Evropian⁵ në vitin 2014. Në të përfshihen shpenzimet që çdo shtet anëtar ka kryer, e orientuar kryesisht për realizimin e objektivave horizontale me interes të përbashkët, ndihmën e dhënë për sektorët të ndryshëm të ekonomisë. Të dhënat përfshijnë ndihmën shtetërore përjashtuar ndihmën që kanë dhënë shtetet anëtare për përballimin e krizës ekonomike, bujqësinë dhe peshkimin.

⁴ http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html

⁵ http://ec.europa.eu/competition/state_aid/scoreboard/index_en.html



2.3 Kategoritë e ndihmës shtetërore

Sipas metodologjisë së Bashkimit Evropian, ndihma shtetërore ndahet në dy kategori:

- Ndihmë shtetërore horizontale; dhe
- Ndihmë shtetërore sektoriale.

Ndihma shtetërore horizontale jepet për një numër të madh përfituesish, pa dhënë preferenca për ndonjë aktivitet ekonomike ndërmarrje ekonomike, produkt apo shërbim, duke minimizuar efektet në konkurrencë.


Ndihma shtetërore sektoriale jepet për aktivitete dhe sektorë të veçantë, duke pasur një ndikim më të madh në konkurrencën në treg.

Tabela nr. 3. Ndihma shtetërore gjithsej 2011–2015 ndarë sipas kategorive (përfshirë bujqësinë dhe peshkimin-vlerat në mln lekë)

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS

Kategoria	2011		2012		2013		2014		2015	
	mln lekë	në %	mln lekë	në %	mln lekë	në %	mln lekë	në %	mln lekë	në %
Bujqesia	2,167.58	13.10	2,163.85	10.07	1,156.90	5.73	1,170.82	18.00	1,549.61	25.13
Ndihma Horizontale	11,982.85	72.42	16,805.53	78.24	17,881.62	88.62	4,217.05	64.85	3,681.09	59.69
Punësimi	37.25	0.23	23.30	0.11	21.10	0.10	150.08	2.31	285.34	4.63
Trajnimi	62.30	0.38	64.80	0.30	63.10	0.31	109.84	1.69	136.69	2.22
Kultura	-	-	-	-	-	-	-	-	41.15	-
Sport	-	-	-	-	-	-	-	-	2,058.00	-
Mjedisi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Eksperti	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ndihma Operacionale	2,483.52	15.01	2,205.33	10.27	1,160.12	5.75	1,247.99	19.19	1,130.86	18.34
Shpetim dhe ristrukturim	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kerkim, zhvillim dhe inovacion	9,399.78	56.81	14,504.00	67.52	16,629.32	82.41	2,027.68	31.18	-	-
SME	-	-	8.10	0.04	7.98	0.04	37.46	0.58	29.05	0.47
të tjera	-	-	-	-	-	-	644.00	9.90	-	-
Ndihma Sektoriale	2,394.86	14.47	2,511.39	11.69	1,139.61	5.65	1,115.25	17.15	935.90	15.18
Transport publik (hekurudha)	452.00	2.73	440.00	2.05	440.00	2.18	440.00	6.77	440.00	7.14
Sherbimet publike	773.00	4.67	787.00	3.66	600.00	2.97	450.00	6.92	430.00	6.97
Miniera	5.00	0.03	13.00	0.06	13.90	0.07	30.00	0.46	65.90	1.07
Energjia	1,161.97	7.02	1,268.50	5.91	85.71	0.42	195.25	3.00	-	-
Turizmi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
te tjera	2.89	0.02	2.89	0.01	-	-	-	-	-	-
TOTALI	16,545.29	100	21,480.77	100	20,178.13	100	6,503.12	100	6,166.60	100

Grafiku nr. 2. Ndhimja shtetërore sipas kategorive



Të dhënat në tabelën 3 dhe të paraqitura në grafikun 2, tregojnë se në vitin 2015 ndihma horizontale vazhdon të zë pjesën më të madhe të ndihmës shtetërore gjithsej me 60%, ndërsa kategoria e ndihmave sektoriale përbën 15.18%.

2.3.1 Ndihma shtetërore horizontale


Në vitin 2015 ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 3.681,09 mln lekë (26.81 mln euro) dhe e krahasuar me vitin 2014 ka zbritur me 12,71 %. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2015 ka zbritur me 40 % krahasuar me vitin 2014.

Tabela nr. 4. Ndihma shtetërore horizontale 2013–2015 (mln lekë/mln euro)



Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS

Ndihma horizontale	2013		2014		2015		Index 2014/201	Index 2015/20
	mln ALL	mln EUR	mln ALL	mln EUR	mln ALL	mln EUR		
<i>kursi mesatar i kembimit</i>		140.27		140.11		137.28	3	14
Punesimi	21.07	0.15	150.08	1.07	285.34	2.08	712.46	190.13
Kultura	-	-	-	-	41.15	0.30	-	-
Mjedisi	-	-	-	-	-	-	-	-
Eksporti	-	-	-	-	-	-	-	-
Ndihma operacionale	1,160.10	8.27	1,247.99	8.91	1,130.86	8.24	107.58	90.61
Shpetim dhe ristrukturim	-	-	-	-	-	-	-	-
Kerkim dhe Zhvillim	16,629.32	118.55	2,027.68	14.47	-	-	12.19	-
SME-te	7.98	0.06	37.46	0.27	29.05	0.21	469.42	-
Sport	-	-	644.00	4.60	2,058	14.99	-	-
Trajnim	63.10	0.45	109.84	0.78	136.69	1.00	174.07	124.44
Total	17,881.57	127.48	4,217.05	30.10	3,681.09	26.81	23.58	87.29

Grafiku nr. 4. Ecuria e ndihmës shtetërore horizontale (mln euro)



Grafikët nr. 5 dhe 6. Struktura e ndihmës shtetërore horizontale në vitet 2013–2015





Nga grafikët e mësipërm vërehet se ndihma horizontale gjatë vitit 2015 ka pësuar rënie krahasuar me vitet e mëparshme. Nga 4.217,05 mln lekë në fund të vitit 2014, ka zbritur në 3.681,09 mln në vitin 2014. Rënia i atribuohet zvogëlimit të ndihmës për kërkim dhe zhvillim. Gjithsesi, vlen të theksohet që brenda kategorisë së ndihmës horizontale është rritur ndjeshëm ndihma për SME-të, ndihma për punësim dhe ndihma për trajnim, duke përmirësuar më tej strukturën ndihmës horizontale dhe arritjen e qëllimit për të cilin jepet ndihma shtetërore.

Ndihma për kërkim dhe zhvillim: Për vitin 2015, nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), është raportuar se asnjë subjekt që kryen operacione hidrokarbure në Shqipëri nuk kanë përfituar përjashtime në import (TVSH-ja dhe përjashtime doganore), përjashtime në akcizë dhe përjashtimi nga TVSH-ja për shërbimet. Kjo lloj ndihme, në vitet paraardhëse, zinte pjesën më të rëndësishme në kategorinë e ndihmës horizontale.

Ndihma operacionale: Kjo kategori përfshin skemën e rimbursimit të akcizës së lëndëve djegëse të konsumuar në serat me ngrohje dhe industri⁶. Për vitin 2015, Ministria e Financave për këtë kategori raporton se shuma e ndihmës ka arritur në vlerën e 1.130 milionë lekë⁷.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, dispozitat në zbatim të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë””, ku bazohej skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për importin e makinerive dhe pajisjeve⁸, janë shfuqizuar.

Ndihma për trajnim: Mbështetur në raportimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP) ndihma për trajnim në vitin 2015 është rritur në krahasim me vitin 2014. Nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nëpërmjet formimit në

punë⁹, kanë përfituar 69 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2014 ishin 51 ndërmarrje përfituese), në sektorin e konfeksioneve/prodhim këpucësh, duke u krijuar gjithsej 1299 (në vitin 2014 u krijuan 1071 vende të reja të punës).

Ndihma për punësim: Sipas të dhënave të SHKP-së, ndihma për punësim në vitin 2015 është rritur në krahasim me vitin 2014. Nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë nga grupe të veçanta¹⁰ kanë përfituar 320 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2014 ishin 172 ndërmarrje përfituese) me veprimtari ekonomike në fushën e prodhimit të këpucëve dhe konfeksione, duke u krijuar 3183 vende të reja të punës (në vitin 2014 u krijuan 2221 vende të reja të punës). Në programin e nxitjes së punësimit të praktikave profesionale për punëkërkuesit që kanë mbaruar arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit¹¹, kanë përfituar 145 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2014 ishin 97 ndërmarrje përfituese), duke u krijuar 857 vende të reja pune (në vitin 2014 u krijuan 436 vende të reja të punës). Nga programi i nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta¹², kanë përfituar 17 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2014 ishin 12 ndërmarrje përfituese), duke u krijuar 192 vende të reja të punës (në vitin 2014 u krijuan 120 vende të reja të punës). Nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj¹³, kanë përfituar 43 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (në vitin 2014 ishin 21 ndërmarrje përfituese), në sektorin e telekomunikacionit, konsulencës, agropërpunimit dhe *call center*, duke krijuar 263 vende të reja të punës (në vitin 2014 u krijuan 117 vende të reja pune). Sa i përket programit të nxitjes së punësimit

⁹ Vendimi i KNSH-së nr. 12, datë 15.3.2007, “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit në punë””.

¹⁰ Vendimi i KNSH-së nr. 11, datë 15.3.2007, “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, të punëkërkuesve të papunë””.

¹¹ Vendimi i KNSH-së nr. 13, datë 15.3.2007, “Për skemën ekzistuese “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit institucional””.

¹² Vendimi i KNSH-së nr. 38, datë 19.9.2011, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta””.

¹³ Vendimi i KNSH-së nr. 39, datë 19.9.2011, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë””.

⁶ Vendimi i KNSH-së nr. 24, datë 2.5.2008, “Për përcaktimin e kushteve dhe procedurave për rimbursimin e akcizës së lëndëve djegëse, të konsumuar në serat me ngrohje për prodhimin e produkteve industriale dhe agroindustriale, të cilat përdoren për nevojat teknologjike të prodhimit”.

⁷ Ku përfshihet 597.087 mijë lekë akciza për bikoraburantet dhe 533.774 për lëndët djegëse të konsumuara në serra.

⁸ Vendimi i KNSH-së nr. 17, datë 16.7.2007, “Për skemën e shtyrjes së pagesës së TVSH-së makinerive dhe pajisjeve të importuara, si dhe të energjisë elektrike të importuar nga KESH sh.a.”.



të personave me aftësi të kufizuar¹⁴, për vitin 2015 nëpërmjet tij kanë përfituar 18 ndërmarrje të vogla dhe të mesme (nga 8 përfitues për 2014) në sektorin e ndërtimit, konfeksion dhe shërbimeve, duke i krijuar 29 vende të reja të punës (nga 14 vende të reja pune për vitin 2014).

Në kategorinë e ndihmës horizontale përfshihet, gjithashtu, *ndihma për SME-të*. Dhënës i ndihmës është Drejtoria e Mbështetjes së Sipërmarrjes në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), ndërsa autoriteti përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kësaj mase është Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA). Për vitin 2015, AIDA ka pasur në administrim 6 skema të ndihmës shtetërore, nga të cilat Fondi i Inovacionit, Fondin i Grave Sipërmarrëse dhe skema *Voucher* nuk kanë qenë aktive.

Sa u përket skemave të tjera, AIDA raporton se:

- Nga fondi shqiptar i ekonomisë kreative¹⁵ kanë përfituar ndihmë shtetërore, gjithsej, 9 ndërmarrje të vogla dhe të mesme, në shumën 4.854 mln lekë. Ndihma shtetërore për këto ndërmarrje ka ndikuar në rritjen e kapaciteteve prodhuese të biznesit, zgjerimin e linjës së produkteve trendi, të cilat konsumatori i kërkon në mënyrë të vazhdueshme, si edhe rritjen e të ardhurave.

- Nga fondi shqiptar i konkurrueshmërisë¹⁶ kanë përfituar ndihmë shtetërore, gjithsej, 28 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në shumën 21.54 mln lekë. Ndihma shtetërore për këto ndërmarrje ka ndikuar në rritjen e produktivitetit, përmirësimin e imazhit të ndërmarrjeve në tregun vendas dhe ndërkombëtar, rritjen e besueshmërisë të konsumatorët e produkteve/shërbimeve, si edhe forcimin e kapaciteteve menaxheriale.

- Nga Fondi *Start-Up* kanë përfituar 11 ndërmarrje të vogla dhe të mesme në shumën e 2.35 mln lekë. Ndihma shtetërore për këto ndërmarrje ka nxitur krijimin dhe konsolidimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Ndihma për sportin: Komisioni i Ndhmës Shtetërore¹⁷ ka autorizuar ndihmën shtetërore për rikonstrukcionin e stadiumit “Elbasan Arena” (444 milionë lekë janë financuar me fonde nga buxheti i shtetit), me qëllim organizimin e ri të ambienteve të brendshme të godinës ekzistuese dhe zgjerimin e saj me pjesë të re, duke ofruar shërbimet e nevojshme për median në harmoni me kërkesat e parashtruara nga UEFA. Komisioni autorizoi ndihmën shtetërore për ndërtimin e stadiumit “Elbasan Arena” dhe Parkut Olimpik të Tiranës, të parashikuar në VKM-në nr. 411, datë 20.6.2014, “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta” Elbasan, dhe financimin e Parkut Olimpik të Tiranës”, mbështetur në nenin 13, pika 3, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, sepse skema mbështet realizimin e dy projekteve të rëndësishme dhe me ndikim të konsiderueshëm në cilësinë e sportit shqiptar si edhe lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike.

Komisioni me vendimin nr. 54, datë 26.1.2015, “Për skemën ekzistuese të mbështetjes me grante nga buxheti i shtetit në sektorin e sportit”. Për këtë skemë ndihmë, objektivi kryesor i së cilës është nxitja e kulturës së sportit, edukimit të sportit dhe aktiviteteve fizike duke rritur pjesëmarrjen e shtetasve në sport, për vitin 2015, janë shpenzuar nga buxheti i shtetit 114 milionë lekë.

Gjithashtu, me vendimin nr. 59, datë 14.9.2015, është autorizuar ndihma shtetërore për rindërtimin e stadiumit “Loro Boriçi”, Shkodër, në shumën 1 500 000 000 lekë.

Ndihma për kulturën: Me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e kulturës, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe muzeve, përmirësimin e strukturës së industrisë shqiptare të filmit, cilësinë dhe shumëllojshmërinë e saj, në bazë të vendimit nr. 56, datë 4.6.2015, Komisioni ka autorizuar ndihmën shtetërore për veprimtaritë, të mirat dhe shërbimet kulturore.

2.3.2 Ndihma shtetërore sektoriale

Në vitin 2015 ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 935.90 mln lekë (6,82 mln euro), 16.08% më pak krahasuar me vitin 2014.

¹⁴ Vendimi i KNSH-së nr. 47, datë 28.3.2014, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar””.

¹⁵ Vendimi i KNSH-së nr. 45, datë 28.3.2014, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore “Për krijimin e fondit të ekonomisë kreative (artizanati)””.

¹⁶ Vendimi i KNSH-së nr. 10, datë 2.2.2007, “Për planin e dhënies së ndihmës shtetërore për grantin “Për krijimin e fondit shqiptar të konkurrueshmërisë””.

¹⁷ Vendimi i KNSH-së nr. 53, datë 26.1.2015, “Për skemën e ndihmës shtetërore në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 411, datë 20.6.2014, “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta” Elbasan, dhe financimin e Parkut Olimpik të Tiranës””.



Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2015 është 15.18%.


Tabela nr. 5. Ndihma shtetërore sektoriale 2012–2014 (mln lekë/mln euro)

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS

Ndihma Sektoriale	2013		2014		2015		ndryshimi 2014/2013	ndryshimi 2015/2014
	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR	mln LEK	mln EUR		
<i>kursi mes i kembimit</i>	140.27		140.11		137.28			
<i>Transport publik (hekurudha)</i>	440.00	3.14	440.00	3.14	440.00	3.21	100.00	100.00
<i>Sherbimet publike</i>	600.00	4.28	450.00	3.21	430.00	3.13	75.000	95.56
<i>Miniera</i>	13.90	0.10	30.00	0.21	65.90	0.48	215.827	219.67
<i>Energjia</i>	85.71	0.61	195.25	1.39	-	-	227.80	-
<i>Turizmi</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
<i>te tjera</i>	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI	1,139.61	8.12	1,115.25	7.96	935.90	6.82	97.86	83.92

Grafiku nr. 7. Struktura e ndihmës shtetërore sektoriale 2013–2015

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS



Në strukturën e ndihmës sektoriale (vertikale) për vitin 2015, peshën më të lartë e zë ndihma për transportin publik (hekurudha), e ndjekur nga ndihma shërbimet publike (ndihma për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe ndihma për minierat (në mbyllje dhe konservim). Për vitin 2015 nuk është dhënë ndihmë për energjinë, si rezultat i shfuqizimit të skemës.

Për sa i takon transportit publik ndihma shtetërore është dhënë nga buxheti i shtetit për mbështetjen e transportit hekurudhor, i cili nuk ndryshon me vlerën e subvencionit të akorduar në vitin 2014.

Ndihma për shërbimet publike: Autoriteti dhënës është Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, ndërkohë që institucioni përgjegjës është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve (DPUK). Ndihma për shërbimet publike është në formën e subvencionit nga buxheti i shtetit¹⁸. Sipas raportimit nga DPUK-ja, numri i përfituesve të ndihmës për vitin 2014 është 50 ndërmarrje ujësjellës-kanalizime dhe 5 sisteme ujësjellës-kanalizime që administrohen nga komunat. Përfituesit kryesorë të ndihmës janë sh.a. ujësjellës-kanalizime, në qytetet Durrës, Patos, Kavajë, Ujësjellës Shkodër Fshat dhe sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Elbasan Fshat.

¹⁸ Vendimi i KNSH-së nr. 5, datë 20.10.2006, “Për skemën ekzistuese të subvencionimit të ndërmarrjeve të ujësjellësit”



2.4 Instrumentet e shpërndarjes së ndihmës shtetërore

Ndihma shtetërore e dhënë nga burime shtetërore, në varësi të llojit (instrumentit) të përdorur, përbën një shpenzim real apo potencial të pasurisë publike, duke pasur një efekt në mbledhjen e të ardhurave publike. Në vitin 2015, ndihma shtetërore është dhënë kryesisht në formën e subvencioneve dhe lehtësirave tatimore. Referuar metodologjisë së përdorur nga BE-ja, instrumentet e ndihmës shtetërore,

klasifikohen në:

A1 - Subvencione dhe grante;

A2- Përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale;

B - Pjesëmarrja në kapital;

C1 - Hua të buta;

C2 - instrumente të tjera;

D – Garancitë.


Tabela nr. 6. Ndihma shtetërore gjithsej sipas instrumenteve

Burimi: Drejtoria e Tregut të Brendshëm, MZHETTS

Kategoria e ndihmës		Subvencion e dhe Grante (A1)	Përfshirja nga taksat, shtyrja e taksave, ulja e normës së taksave dhe zbritje e kontributit në sigurimet sociale (A2)	Të tjera instrumente (C 2)	Totali
I	Ndihmat horizontale				3,681
	1 Punësimi	285.34			285.34
	2 Ndihma operacionale		1,130.86		1,130.86
	3 Kërkimi dhe Zhvillimi				-
	4 SME-të	29.05			29.05
	5 Trainimi	136.69			136.69
	6 Kultura	41.15			41.15
	7 Sporti	2,058.00			2,058.00
II	Ndihma sektoriale				935.90
	8 Transporti publik	440.00			440.00
	9 Shërbimet publike	430.00			430.00
	10 Minierat	65.90			65.90
	11 Energjia				-
	12 Televizionet/mediat			-	-
TOTALI		3,486.13	1,130.86	-	4,616.99

Të dhënat në tabelën nr. 6 tregojnë se instrumenti i përdorur më shumë është A1 - subvencione dhe grante dhe instrumenti A2- lehtësira tatimore, sikurse paraqitet edhe në grafiku nr. 7.

Grafiku nr. 7. Struktura e shpërndarjes së instrumenteve të ndihmës shtetërore



3. PËRMBLEDHJE

Raporti vjetor i monitorimit të ndihmës shtetërore për vitin 2015 është hartuar në përputhje me metodologjinë e Komisionit Evropian në fushën e raportimit të ndihmës shtetërore. Raporti vjetor për ndihmat shtetërore për vitin 2015 përfshin, gjithashtu, të dhëna për ndihmën në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit, edhe pse ky sektor nuk bën pjesë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”. Ndihma shtetërore *përfshirë* sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2015 është dhënë në vlerën totale prej 6.166.60 mln lekë (44,92 mln euro).

Ndihma shtetërore *përfshirë* sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në vitin 2015 është dhënë në vlerën totale prej 4.616,99 mln lekë (33,63 mln euro).

Ndihma shtetërore horizontale në vlerë absolute është 3.681,09 mln lekë (26.81 mln euro) dhe e krahasuar me vitin 2014 ka zbritur me 12,71 %. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2015 ka zbritur me 40 % krahasuar me vitin 2014.

Ndihma shtetërore sektoriale në vlerë absolute është 935.90 mln lekë (6,82 mln euro), 16.08 % më pak krahasuar me vitin 2014. Pesha për këtë kategori në totalin e ndihmës në vitin 2015 është 15.18 %.

Ndihma shtetërore për vitin 2015 karakterizohet nga një:

- rritje e ndihmës shtetërore në sport, kulturë, për punësim, trajnim, ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të përfshira në kategorinë e ndihmës horizontale,

- instrumentet e përdorura më shumë janë A1
- subvencione dhe grante dhe instrumenti A2
- përfshirje nga taksat, shtyrje e taksave, ulje e normës së taksave.

VENDIM

Nr. 518, datë 13.7.2016

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 55, DATË 5.2.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË NDIHMËS SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 16, të ligjit nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 55, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, nëndarjet me fjalët “znj. Dareka Dariu - anëtar” dhe “znj. Anduena Dedja - anëtar” zëvendësohen, përkatësisht, me “z. Petrit Bakiu - anëtar” dhe “z. Gramoz Hoxha - anëtar”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**VENDIM****Nr. 519, datë 13.7.2016****PËR MIRATIMIN E MODELIT TË
TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 97, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OSHEE sh.a., OST sh.a. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI**Niko Peleshi****MODELI SHQIPTAR I TREGUT****Hyrje**

Zhvillimi dhe miratimi i Modelit Shqiptar të Tregut (MSHT) është hapi i fundit drejt zhvillimit të tregut të energjisë elektrike të Shqipërisë në një treg plotësisht konkurrues të energjisë, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Ky miratim është pjesë e reformës që qeveria e Shqipërisë ka ndërmarrë për rindërtimin e sektorit të energjisë elektrike, në përputhje me ligjin e ri nr. 43/2014, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe politikat e qeverisë për zhvillimin e këtij sektori.

Së pari, Modeli Shqiptar i Tregut (MSHT) është hartuar në bazë të kërkesave të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për krijimin e tregut rajonal të energjisë elektrike, i cili është ratifikuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2006. Në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Shqipëria është angazhuar për zbatimin e paketës së tretë të energjisë, që është miratuar nga Këshilli i Ministrave të këtij Traktati në vitin 2011.

Së dyti, Shqipëria është angazhuar në Samitin e Vjenës, më 27 gusht 2015, të zbatojë një sërë masash afatshkurtra, në kuadër të procesit të

Berlinit (Ballkani Perëndimor 6). Modeli i tregut synon mbështetjen për zbatimin e angazhimeve të marra në kuadër të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe akteve nënligjore përkatëse.

Së treti, si një proces i lidhur ngushtë me dy zhvillimet e përmendura më sipër, është iniciuar një proces drejt krijimit të Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE), i cili kërkon, gjithashtu, përafrimin e mëtejshëm të tregut të energjisë elektrike, në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara nga Komuniteti i Energjisë.

Ky model pritet të sigurojë një strukturë të qëndrueshme dhe të krijojë kushtet për integrimin e mëtejshëm rajonal, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të saj fqinje.

Modeli Shqiptar i Tregut merr në konsideratë:

- harmonizimin e legjislacionit të sektorit të energjisë dhe mënyrës së funksionimit të tregut me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

- finalizimin e procesit të kalimit nga struktura vertikalisht e integruar e sektorit të energjisë elektrike drejt një strukture ligjërish, funksionalisht dhe financiarisht të ndarë në furnizim, prodhim, transmetimit dhe shpërndarje, me qëllim që të mundësojë konkurrencën në tregjet me shumicë dhe pakicë;

- zhvillimin e tregut të energjisë elektrike sipas rregullave të qarta të tregut dhe kodeve të rrjetit, si kushte minimale teknike për një funksionim efikas të sistemit elektroenergetik;

- përfitime më të larta për konsumatorët në drejtim të sigurimit të furnizimit me energji elektrike dhe drejt një shërbimi cilësor;

- shfrytëzimin më efikas të tregtimit ndërkufitar, ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të saj fqinje, duke lejuar përfitimin e sektorit shqiptar të energjisë elektrike në drejtim të përdorimit me eficiencë të burimeve tona gjeneruese;

- zbatimin e aksesit të palëve të treta për të marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e një tregu transparent dhe jodiskriminues;

- liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, duke krijuar një strukturë tregu që rrit interesin e numrin e pjesëmarrësve, krijon kushtet për hapjen e sektorit drejt konkurrencës dhe rrit pjesëmarrjen e investitorëve të huaj;



- monitorimin dhe rregullimin e tregut të energjisë elektrike nga ERE, si një institucion i pavarur;

- nevojën për të hartuar dhe zbatuar rregulla për kryerjen e transaksioneve në tregje transparente dhe jodiskriminuese, për të shmangur manipulimin dhe abuzimin e tregut, si dhe kryerjen e tregtimit të brendshëm, në përputhje me praktikën më të mira evropiane;

- integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike me tregun rajonal të Evropës Juglindore, dhe, më vonë, me tregun evropian të energjisë elektrike, i cili do të jetë një udhëzues i parimeve të funksionimit të këtij tregu.

Në këtë Model, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

“Bursa Shqiptare e Energjisë” - platforma e organizuar për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë;

“Treg energjie elektrike” - një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivativët e energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtra;

“SEE CAO” – Zyra e Koordinuar e Ankandëve në Evropën Juglindore, e krijuar në Podgoricë, Mali i Zi, dhe që ka kompetencë kryerjen e ankandëve të kapaciteteve të transmetimit të OST-ve pjesëmarrëse në këtë zyrë;

“Kontratë për diferencë” (CfD) - një marrëveshje tip, e miratuar nga Këshilli i Ministrave, ndërmjet operatorit të energjisë së rinovueshme dhe prodhuesit të energjisë nga burimet e rinovueshme, i cili është deklaruar ofertuesi i suksesshëm në ankandin për të marrë ndihmë operationale dhe në investime;

“Palë Përgjegjëse Balancuese” - të gjitha subjektet juridike që, në përputhje me këtë model dhe legjislacionin në fuqi, janë përgjegjëse për parashikimin e tyre të prodhimit dhe konsumit;

“Palë Shërbyese për Balancimin” - çdo subjekt juridik që, në përputhje me këtë model dhe legjislacionin në fuqi, ofron shërbime balancimi për OST-në;

“Kontrata financiare OTC” - transaksione financiare të shitblerjes së energjisë elektrike, jo të kryera nëpërmjet bursës së energjisë elektrike.

Çdo term tjetër, i përdorur në këtë model, ka të njëjtin kuptim me atë të përcaktuar në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Ky model nuk do të interpretohet si kufizues apo ndalues me çfarëdo iniciativë në sektorin e energjisë elektrike dhe/ose angazhimeve që Shqipëria mund të ndërmarrë në kuadër të bashkëpunimit rajonal.

1. Qëllimet dhe objektivat e modelit të tregut

1. Qëllimi

1.1 Qëllimi i modelit të tregut:

- Të krijojë kushtet për një treg konkurrues të energjisë elektrike, i cili lejon vendosjen e çmimeve të drejta që burojnë nga zbatimi i një tregu të qëndrueshëm, në përputhje me detyrimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

- Të krijojë kushtet për një treg të orientuar drejt importit dhe eksportit, që promovon përfitimet e konsumatorëve, si dhe përfitime për sektorin shqiptar të energjisë elektrike, duke ofruar fleksibilitet për integrimin në tregun e energjisë elektrike panevropiane dhe bashkimin e tregjeve të ditës në avancë (*day ahead market*) dhe tregun brenda ditës (*intraday market*);

- Të krijojë kushtet për kalimin transparent dhe efikas të flukseve të fondeve dhe llogarive, duke përdorur BSHE-në si një organizëm qendror për të gjithë tregtarët në tregun e organizuar.

1.2 Kërkesat për funksionimin e modelit të tregut në mënyrë eficiente:

- hartimi i rregullave transparente dhe të përshtatshme për BSHE-në, pjesëmarrësit e tregut, përfshirë operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes;

- mbikëqyrja rregullatore nga ERE, me masa shtesë, për të garantuar transparencën, akses të barabartë dhe jodiskriminues në treg dhe në rrjet;

- proceset e monitorimit të tregut dhe të raportimit të të dhënave;

- rregullat e tregut dhe kodet e lidhura me to, që garantojnë një mbrojtje efektive kundër abuzimeve në treg dhe praktikave të padrejta tregtare.

1.3 Qëllimet të tjera të rëndësishme të modelit të tregut:

- të marrë në konsideratë transformimin e subjekteve të integruar vertikalisht, në entitete funksionalisht, ligjrisht dhe financiarisht të



ndara në bazë të kërkesave të paketës së tretë rregullatore;

- të krijojë një strukturë, brenda së cilës të zhvillohet konkurrenca, si në tregun me shumicë ashtu edhe në atë me pakicë, për të mundësuar dhe promovuar ndryshimin e shpejtë të furnizuesit.

2. Objektivat

Modeli Shqiptar i Tregut karakterizohet si një treg me shumicë, i bazuar në transaksione dypalëshe dhe kontrata të lidhura ndërmjet dy pjesëmarrësve të tregut jashtë bursës (*Over the Counter -OTC*) ose si një treg i organizuar i ditës në avancë dhe tregut brenda ditës, i organizuar nëpërmjet bursës BSHE. ERE është përgjegjëse për të miratuar, në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë dhe në konsultim me Autoritetin e Konkurrencës, Komisionin e Ndihmës Shtetërore dhe pjesëmarrësit e tregut, masat e duhura për të siguruar përmbushjen e kriterëve të transparencës dhe të hapjes së tregut si dhe masat në lidhje me sigurinë e furnizimit.

Çdo formë e tarifave apo e çmimeve të rregulluara në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, si dhe çdo formë subvencioni për kategori të ndryshme të konsumatorëve, do të eliminohet, me përjashtim të tarifave të rregulluara, që janë të mbuluara nga detyrimi i shërbimit publik, në përputhje me detyrimet e ligjit për sektorin e energjisë dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Modeli Shqiptar i Tregut synon përmbushjen e objektivave të qeverisë së Shqipërisë në drejtim të:

i) liberalizimit të plotë të tregut të energjisë elektrike dhe krijimit të një tregu/tregjeve të organizuar, pra një treg/tregje konkurrues/e të energjisë për tregtimin e flukseve fizike të ditës në avancë apo brenda ditës;

ii) sigurimit të përputhshmërisë së Modelit Shqiptar të Tregut me dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

iii) funksionimit të tregut të energjisë si treg i energjisë balancuese, mbështetur në përgjegjësinë e palëve për disbalancat, rakordimin qendror të disbalancave dhe lehtësimin e integritetit me tregjet e tjera balancuese;

iv) sigurimit të likuiditetit të nevojshëm, duke nxitur masa për një funksionim efikas të tregut/tregjeve të flukseve fizike të energjisë;

v) rritjes së efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit, duke qartësuar përgjegjësitë dhe detyrimet, si dhe duke siguruar informacion të mjaftueshëm në lidhje me operimin e tregut dhe krijimin e një strukture të qartë për transaksionet e tregut të energjisë elektrike.

Parimet kryesore të modelit të tregut, janë:

- zbatimi i parimit të kostos marxhinale të ofertave në tregjet e organizuara, si pjesë e mbikëqyrjes së tregut, me qëllim shmangien e abuzimit në treg;

- funksionimi si një treg i organizuar i ditës në avancë dhe tregut brenda ditës, për tregtimin e flukseve fizike të energjisë elektrike, në periudhën kohore të ditës në avancë;

- tregtimi i kontratave fizike afatgjata dypalëshe do të lejohet në përputhje me kapacitetin e blerë dhe të nominuar në ankandet eksplicite të organizuara nga SEE CAO;

- të gjitha format e tjera të tregtimit do të jenë vetëm financiare;

- marrëdhëniet kontraktuale janë skemat bazë që shërbejnë për menaxhimin e marrëdhënieve ndërmjet subjekteve të ndryshme në treg.

Objektivi përfundimtar i modelit të tregut është të integrojë tregun energjetik shqiptar në bashkimin e tregut panevropian. Deri në përmbushjen e këtij objektivi, si një zgjidhje e përkohshme,:

- përdorimi i zonave të import/eksportit nënkupton caktimin e ditës në avancë në kapacitetin e import/eksportit nëpërmjet tregut, ku OST-ja vë në dispozicion, si pjesë e shpërndarjes së kapacitetit të tyre të përditshëm, një sasi minimumi (50%) të kapacitetit në dispozicion të tregut e organizuar. Sasia e vlerës minimale duhet të rishikohet në baza mujore. Vlera minimale mund të ndryshohet në bazë të një vlerësimi të përcaktuar nga ana e OST-së, miratuar nga ERE;

- detyrimet për pjesëmarrjen në të, të KESH-it dhe OSHEE-së, ku vëllimet e reduktuara nga kontrata aktuale e furnizimit KESH-OSHEE, bëhen të detyrueshme për t'u tregtuar në tregun e organizuar. Bazuar në një vlerësim nga ERE, një pjesë ose i gjithë volumi i kësaj kontrate do të mund të zbatohet si një kontratë për diferencë (CFD);



- qeveria e Shqipërisë do të ofrojë skemat mbështetëse, në përputhje me *acquis* përkatëse të Komunitetit të Energjisë, në formën e kontratave për diferencë (CFDs) për prodhuesit e pavarur të energjisë elektrike dhe furnizuesit e energjisë së rinovueshme, për të zëvendësuar marrëveshjet e tyre aktuale për blerje të energjisë, duke i lejuar ata të bëhen Palë Përgjegjëse Balancuese (PPB), sipas modelit të tregut. Çdo ndryshim në skemën mbështetëse do të përcaktohet në ligjin për burimet e rinovueshme.

Marrëdhëniet dhe roli i pjesëmarrësve të tregut në operimin fizik të modelit të tregut përcaktohen me marrëveshje ndërmjet pjesëmarrësve individualë dhe BSHE-së e OST-së, ose rregullohet nëpërmjet marrëveshjeve standarde të zbatueshme dypalëshe.

3. Rolet e modelit të tregut

3.1 Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)

OST-ja është kompania e pavarur shtetërore që kryen këto funksione:

- funksionin e operimit fizik të rrjetit të transmetimit (pronësinë, mirëmbajtjen dhe zgjerimin);

- funksionin e Operatorit të Sistemit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 43/2015 dhe direktivës 2009/72/CE, duke përfshirë dispeçerimin;

- sigurimi i shërbimit të lidhjes për të gjithë përdoruesit e sistemit të lidhur me rrjetet e transmetimit, në kushte jodiskriminuese;

- përcakton kushtet për t'u bërë Palë Përgjegjëse Balancuese (PPB) dhe Palë Shërbyese për Balancimin (PSB);

- zbaton procesin e llogaritjes së kapaciteteve ndërkufitare të interkonjeksionit, të koordinuara në përputhje me kërkesat në tregjet e organizuara.

OST-ja kryen funksionin e Operatorit të Tregut Balancues, nëpërmjet:

- parashikimit dhe blerjes së shërbimeve ndihmëse, të ndara në energji balancuese dhe kapacitet rezervë, nga të gjithë Ofruesit e Shërbimeve të Balancuar (OSB-ve), në një javë, ditën përpara dhe afatin kohor real të bazuar në treg;

- kryerjes së veprimeve të nevojshme për balancimin, duke aktivizuar rregullimin sekondar në ulje (*downward*) ose rritje (*upward*) nga rezervat

balancuese dhe/ose të rezervave shtesë balancuese, të ofruara në tregun e balancimit të energjisë elektrike;

- blerjes së humbjeve në transmetim, në tregun e organizuar të ditës në avancë. Për një periudhë ndërmjetëse, ku produktet që tregtohen në një treg të organizuar nuk lejojnë blerjen me kosto optimale të humbjeve, procedurat e prokurimit janë të lejuara për OST-në, sipas rregullave të miratuara nga ERE;

- kompensimit të tij për shërbimet e balancimit, duke siguruar likuidimin financiar mbi baza mujore, nëpërmjet shlyerjes së disbalancave, të mbështetura në rregullat e llogaritjes së disbalancave, duke siguruar nxitjet e duhura për pjesëmarrësit e tregut, që të jenë të balancuar në kohë reale dhe të afërt me kohën reale. Rregullat e llogaritjes së disbalancave pasqyrojnë devijimet ndërmjet gjenerimit të energjisë, energjisë së tregtuar dhe konsumit të palëve përgjegjëse balancuese dhe të ekuilibrit të çdo Pale Përgjegjëse Balancuese. Ajo është e bazuar në një sistem të vetëm të çmimeve, duke penalizuar devijimet në të dyja drejtimet;

- menaxhimit të mbledhjes së kërkuar të të dhënave të matjes, për të kryer një menaxhim efikas të disbalancave dhe shlyerjes financiare të tyre;

- çmimi i energjisë së disbalancave që do të paguhet nga PPB-të do të vendoset në bazë të koston reale për OST-në, për të balancuar sistemin për periudhën përkatëse, që mbulon rezervat balancuese dhe të energjisë.

Tarifat, termat dhe kushtet e aksesit në sistemin e transmetimit do të rregullohen nga ERE.

3.2 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)

OSSH-ja do të zotërojë, mbajë, zgjerojë dhe operojë sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe do të ndahet nga furnizimi, në përputhje me rregullat e Komunitetit të Energjisë.

OSSH-ja do të ofrojë shërbimin e lidhjes për të gjithë përdoruesit e sistemit të lidhur me rrjetin e shpërndarjes në kushte jodiskriminuese.

OSSH-ja do kryejë blerjen e humbjeve teknike dhe joteknike në tregun e organizuar të ditës në avancë (BSHE). Për një periudhë ndërmjetëse, ku produktet që tregtohen në një treg të



organizuar nuk lejojnë blerjen me kosto optimale të humbjeve, procedurat e prokurimit janë të lejuara për OSSH-në, sipas rregullave të miratuara nga ERE.

Tarifat, afatet dhe kushtet e aksesit në sistemin e shpërndarjes do të rregullohen nga ERE.

OSSH-ja do të jetë përgjegjëse për reduktimin e humbjeve teknike dhe joteknike në sistemin e shpërndarjes, në bazë të një studimi të përgatitur nga konsulentë ndërkombëtarë, të kontraktuar nga OSSH-ja dhe të miratuar nga ERE. ERE do të vendosë një tarifë për OSSH-në, që siguron incentiva për reduktimin e këtyre humbjeve.

OSSH-ja do të jetë një PPB.

3.3 Pala Përgjegjëse Balancuese (PPB)

Termat dhe kushtet për t'u bërë një PPB përcaktohen nga OST-ja dhe rregullohen nëpërmjet një marrëveshjeje ndërmjet PPB-së dhe OST-së.

Të gjitha subjektet juridike, që zotërojnë njësi të prodhimit dhe konsumit, të lidhura në rrjet dhe mbi një kapacitet të caktuar nga OST-ja dhe të miratuar nga ERE, janë të detyruara për të qenë një PPB.

Çdo subjekt juridik, që zotëron njësi të gjenerimit dhe konsumit, të lidhura me rrjetin dhe nën një kapacitet të caktuar nga OST-ja dhe të miratuar nga ERE, mund të aplikojnë për t'u bërë një PPB.

Çdo tregtar, që tregton në Shqipëri apo që furnizon energjinë ndërkufitare, është PPB.

PPB-ja lejohet të skedulojë kontratat dypalëshe fizike për të blerë/shitur kapacitet e shpërndara në SEE CAO.

Të gjitha tregtimet e brendshme afatgjata OTC do të bazohen në një kontratë financiare, ku energjia elektrike fizike do të tregtohet nga BSHE-ja dhe çmimi i BSHE-së do të jetë çmimi i referencës për kontratën financiare. ERE do të miratojë kontratën tip financiare OTC.

Të gjitha PPB-të do të jenë përgjegjëse për llogaritjet e disbalancave.

Një PPB mund të marrë përgjegjësitë e PPB-ve të tjera ose të njërive të prodhimit dhe konsumit nën një kapacitet të miratuar.

Të gjitha PPB-të janë përgjegjëse për parashikimin e tyre të prodhimit dhe konsumit.

Të gjitha PPB-të janë të detyruara të mbrojnë informacionin konkurrues dhe konfidencial, kur

është e nevojshme, si dhe çdo informacion të kërkuar nga ERE dhe OST-ja, sipas legjislacionit në fuqi.

Çdo palë që do të ushtrojë aktivitetin e furnizuesit është e detyruar të jetë PPB.

3.4 Ofruesi i Shërbimeve të Balancimi (OSB)

OSB-ja është një PPB që ofron shërbime balancimi për OST-në.

Kushtet dhe kriteret për t'u bërë OSB përcaktohen nga OST-ja dhe rregullohen në një marrëveshje ndërmjet OSB-së dhe OST-së.

3.5 Bursa Shqiptare e Energjisë

Bursa e energjisë kryen këto funksione:

a) siguron të gjitha sistemet dhe ndërveprimet e nevojshme për operimin BSHE (tregun e ditës në avancë);

b) pranon aplikime dhe oferta për të blerë dhe shitur energji nga PPB-të;

c) merr dhe proceson kapacitetet e interkonjeksionit nga OST-ja, si dhe informacione të tjera përkatëse;

ç) kryen ankandet e nevojshme dhe operacionet tregtare, në përputhje me rregullat e miratuara, duke përdorur për këtë qëllim algoritmat e evropean market coupling;

d) i dërgon PPB-ve përkatëse dhe OST-së, sipas afateve të përcaktuara, konfirmimet tregtare, duke përfshirë sasi të alokuara dhe çmimet;

dh) publikon sasi të shpërndara dhe çmimet përkatëse, sipas afateve të përcaktuara;

e) i dërgon PPB-ve përkatëse dhe OST-së, në përputhje me afatin e rënë dakord, njoftimet e kredive, llogaritë financiare;

ë) ekzekuton mjetet e shtrëngimit dhe pagesat për PPB-të përkatëse, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara;

f) mban dokumentet e transaksioneve;

g) mban dhe përditëson kalendarin e tregtimeve;

gj) respekton kërkesat për transparencë dhe ushtron kompetenca të monitorimit të tregut;

h) garanton që platforma tregtare është e aksesueshme nga gjitha palët e interesuara.

Bursa e energjisë mund të kontraktojë kryerjen e një apo më shumë shërbimeve të sipërcituara nga çdo subjekt që mund të ushtrojë këtë aktivitet, në përputhje me licencën e lëshuar nga ERE.



Si pjesë e krijimit të Bursës Shqiptare të Energjisë do të implementohet ndarja ligjore dhe financiare e Operatorit të Tregut nga OST-ja, deri më 31 dhjetor 2017, siç është përcaktuar në ligjin për sektorin e energjisë elektrike.

Për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë do të implementohet plani i masave, i përcaktuar në anekset 1 dhe 2, të këtij modeli.

4. Roli i rregullatorit të pavarur (ERE)

ERE ushtron kompetencat e saj në zbatim të ligjit për sektorin e energjisë elektrike dhe direktivën 2009/72/CE.

Në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ERE do të reflektojë ndryshimet në Rregullat e Tregut dhe legjislacionin sekondar të nevojshëm për funksionimin e tregut. Në hartimin e këtyre rregullave, ERE do bashkëpunojë ngushtësisht me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

ERE, gjithashtu, do të miratojë rregullat për menaxhimin e kapaciteteve të kufizuara, të cilat hartohen nga OST-ja. ERE do të përcaktojë në Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut rregullat për implementimin e kufizimeve të ngarkesës ndërmjet konsumatorëve, kur ka një kufizim kapaciteti. Hartimi i këtyre rregullave duhet të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit, në mënyrë që këto rregulla të jenë në përputhje me Traktatin e Komunitetit të Energjisë. Në hartimin e këtyre rregullave, duhet të kërkohej mendimi i secilës palë të interesuar si dhe i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

ERE do të miratojë marrëveshje apo kontrata tip për një sërë marrëdhëniesh ndërmjet pjesëmarrësve të tregut, të cilat përfshijnë:

- marrëveshje shërbimi të dyanshme, për shërbimet e shpërndarjes, ndërmjet OSSH-së dhe përdoruesve të sistemit të shpërndarjes;
- marrëveshje për shërbimet e transmetimit, ndërmjet OST-së dhe PPB-ve;
- modele të kontratave financiare OTC, ndërmjet PPB-ve;
- kontrata tip, ndërmjet Bursës së Energjisë dhe PPB-ve, në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira evropiane.

ERE do të jetë përgjegjëse për përpunshmërinë e modeleve të kontratave me kuadrin ligjor fiskal.

Zbatimi i kontratave dhe i detyrimeve tarifore nga gjithë pjesëmarrësit e tregut, duke përfshirë pagesën e plotë për energjinë dhe shërbimet e tjera, është thelbësore për suksesin e tregut shqiptar të energjisë elektrike.

ERE, në bashkëpunim me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, OST-në, Bursën e Energjisë, OSSH-në dhe pjesëtarët e tjerë të tregut, do të hartojnë skema të ekzekutimit të pagesave, që adresojnë çështjet e mospagesave apo pagesave të pjesshme. Për më tepër, ERE do të hartojë rregulla dhe procedura për ushtrimin e autoritetit e saj rregullator mbi PPB-të, në përputhje me marrëveshjet dhe do të ketë, gjithashtu, mundësinë e monitorimit të fluksit të parave. ERE do përdorë të gjitha instrumentet shtrënguese për zbatimin e pagesave dhe detyrimeve tarifore.

5. Pjesëmarrja në tregun e organizuar nuk do të jetë e kushtëzuar nga lëshimi i ndonjë licence specifike nga ana ERE-s. Licencat për OST-në dhe OSSH-në do lëshohen në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike dhe legjislacionin sekondar. ERE do të përcaktojë kriteret dhe procedurën për licencimin e Bursës së Energjisë Elektrike.

5. Marrëveshjet e blerjes së energjisë elektrike

Qeveria shqiptare inkurajon investimet private në burime gjeneruese, për të përmbushur kërkesat e Shqipërisë për energji elektrike, për garantimin e sigurisë së furnizimit, nëpërmjet diversifikimit të burimeve gjeneruese.

Në përputhje me ligjin e sektorit të energjisë elektrike dhe ligjin e konkurrencës, ERE dhe Autoriteti i Konkurrencës, në bashkëpunim të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, do të përdorin autoritetin e tyre për të kufizuar afatin e kontratave afatgjata ndërmjet pjesëtarëve të tregut, në mënyrë që të shmangen efektet bllokuese në zhvillimin e tregut.

6. Procesi i likuidimit financiar

Procedurat e likuidimit financiar do të përfshihen në marrëveshjet tip përkatëse.

Procedurat e likuidimit financiar do të hartohen në mënyrë që të garantojnë transparencën dhe shlyerjen e TVSH-së gjatë procesit të pagesës, duke u siguruar që detyrimet e TVSH-së të mos pengojnë pjesëmarrjen në treg.



ERE do sigurojë që aktivitetet e palëve do kryhen në përputhje me këto rregulla dhe që të gjitha transaksionet financiare të jenë plotësisht transparente dhe të auditueshme.

Modeli i tregut synon të minimizojë riskun e manipulimit të tregut, duke u siguruar, kështu, tregtarëve garanci për funksionimin e tregut. Marrëdhëniet kontraktore ndërmjet pjesëmarrësve të tregut duhet të jenë të mirëpërcaktuara.

Periodha e pagesave të disbalancave duhet të harmonizohet me periudhat e produkteve të tregut, duke lejuar, kështu, PPB-të të balancojnë portofolet e tyre.

7. Marrëveshjet tip

Të gjitha marrëveshjet tip, që hartohen dhe miratohen në përputhje me këtë model tregu:

- do t'u nënshtrohen një faze konsultimi me publikun, për të paktën katër javë, duke përfshirë publikimin në *website* dhe një njoftim për afatin e konsultimit, nga subjektet përgjegjëse për hartimin dhe miratimin e marrëveshjeve tip përkatëse. Rezultatet e konsultimeve publike do të publikohen;

- do t'u nënshtrohen një procesi të rregullt rishikimi, i cili mund të iniciohet me propozim të çdo pjesëmarrësi tregu;

- do të jenë hartuar apo rishikuar sipas një procedure të miratuar nga çdo subjekt përgjegjës për hartimin dhe rishikimin e marrëveshjeve tip. Kjo procedurë do të publikohet;

- do të synojnë të përafrojnë kërkesat e pjesëmarrësve të tregut me kërkesat në Komunitetin e Energjisë, duke marrë në konsideratë praktikatat më të mira evropiane në hartimin dhe kontrollin e marrëveshjeve tip;

- do të vihen në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze. I gjithë dokumentacioni mbi hartimin, kontrollin, konsultimin dhe miratimin e marrëveshjeve tip duhet, gjithashtu, të vihen në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze;

- do të dërgohen për konfirmim në Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë para miratimit.

8. Zbatimi i modelit të tregut

Modeli i tregut të organizuar, siç është përcaktuar në këtë tekst, do të jetë i aplikueshëm në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë.

ANEKS 1

PLANI I MASAVE PËR IMPLEMENTIMIN E TREGUT SHQIPTAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Faza e parë, nga 1 janari

2017 (ose në momentin e hapjes së tregut)

Tregu i rregulluar			
Blerje MWh		Shitje MWh	
Tarifa të rregulluara për konsumatorët në 10,6 dhe 0.4 kv	4.450.000	3.250.000	KESH
		1.200.000	IPP
TOTALI	4.450.000	4.450.000	TOTALI
Tregu i parregulluar			
Blerje MWh		Shitje MWh	
Klientë në TL	1.000.000	2 655 000	Import ose gjenerim nga PPB ¹⁹
Klientë në 35 kv	45.000		
Klientë në 20 kv	310.000		
Humbjet e OSHEE	1.300.000		
TOTALI	2.655.000	2.655.000	TOTALI

¹⁹ Pala Përgjegjëse për Balancimin (siç përkufizuar në tekstin e modelit të tregut) do të përfshijë në fazën e parë volumet e mëposhtme:

- furnizues të kualifikuar për rrjetin e tensionit të lartë - parashikohet 1 TWh;
- volumet që mbesin nga KESH-i pas mbulimit të kërkesës për konsumatorët me tarifa të rregulluara - parashikohet 250 GWh;
- prodhuesit e pavarur (p.sh., Devoll Hydropower, HEC Bistriac dhe Ulzë Shkopet, Fani) – parashikohet 405 GWh;
- importe nëpërmjet tregtimit/ose zonave të import/eksportit + tregtare të tjerë të kualifikuar – parashikohet 1 GWh.



Faza e dytë, nga 1 janari 2018

Tregu i rregulluar			
Blerje MWh		Shitje MWh	
Klientë me tarifa të rregulluara në 0.4 kv	3.500.000	3.500.000	KESH
CFD ²⁰ për 50% të volumit të tarifave të rregulluara	(1.750.000)	(1.750.000)	
TOTALI	1.750.000	1.750.000	TOTALI
Tregu i parregulluar			
Blerje MWh		Shitje MWh	
CFD ² për 50% të volumit të tarifave të rregulluara	1.750.000	1.750.000	
Klientë në TL	1.000.000	3 505 000	Import ose gjenerim nga PPB ²¹
Klientë në 35 kv	45.000		
Klientë në 20 kv	310.000		
Klientë në 10.6 kv	550.000		
Klientë në 0.4 kv	400.000		
Humbjet e OSHEE-së	1.200.000		
TOTALI	5.255.000	5.255.000	TOTALI

Faza e tretë, nga 1 janari 2019

Tregu i rregulluar			
Blerje MWh		Shitje MWh	
Konsumatorë me tarifa të rregulluara 0.4 kv	2.900.000	2.900.000	KESH
CFD ² për 70% të volumit të tarifave të rregulluara	(2.030.000)	(2.030.000)	
TOTALI	870.000	870.000	TOTALI
Tregu i parregulluar			
Blerje MWh		Shitje MWh	
CFD ² për 70% të volumit të tarifave të rregulluara	2.030.000	2.030.000	
Klientë në TL	1.000.000	4 205 000	Import ose gjenerim nga PPB ²²
Klientë në 35 kv	45.000		
Klientë në 20 kv	310.000		
Klientë në 10.6 kv	550.000		
Klientë në 0.4 kv - tregtare, jobuxhetore	1.000.000		
Humbjet e OSHEE-së	850.000		
Klientë jashtë Shqipërisë	450.000		
TOTALI	6.235.000	6.235.000	TOTALI

Në asnjë fazë të planit të masave për implementimin e tregut të energjisë elektrike, nuk do ndalohen pjesëtarët e tregut që, nëse dëshirojnë, të marrin pjesë në tregun e parregulluar të shumicës për blerje dhe shitje të energjisë

²⁰ Kontrata për diferencë (CFD), është një mekanizëm financiar që do të përdoret si një masë e përkohshme që do të lejojë lëvizjen e vëllimeve nga marrëveshjet dypalëshe kontraktuale në BSHE dhe më tej do të jenë pjesë e tregut. Duke përdorur CFD, bëhet e mundur respektimi i tarifës së rregulluar përmes detyrimit të shërbimit universal që është aktualisht në fuqi midis KESH-it dhe OSHEE-së, duke lënë gradualisht pjesë të vëllimit në tregun e parregulluar.

²¹ PPB-JA e mëposhtme, në një fazë të dytë, do të përfshijnë volumet e mëposhtme indikativë:

- furnizuesit e kualifikuar për rrjetin e tension të lartë - rreth 1 TWh;
- prodhuesit e pavarur (p.sh., Devoll Hydropower, HEC Bistrica dhe Ulëz Shkopet, Fani) – rreth 1005 GWh;
- importe nëpërmjet tregtarëve dhe/ose zonave të importeve/eksporteve + tregtarëve të tjerë të kualifikuar – rreth 1,5 GWh;
- volumet CFD (nga KESH-i) – rreth 1,75 GWh.

²² PPB-ja e mëposhtme, në një fazë të tretë do të përfshijnë volumet indikative të mëposhtme:

- furnizuesit e kualifikuar për rrjetin e tensionit të lartë - rreth 1 Twh;
- prodhuesit e pavarur (p.sh., Devoll Hydropower, HEC Bistria dhe Ulëz Shkopet, Fani) – rreth 1005 Gwh;
- volumet e mbetura nga KESH-i pas plotësimit të kërkesës nga klientët me tarifa të rregulluara - rreth 600 Gwh;
- importe nëpërmjet tregtarëve dhe/ose nëpërmjet zonave të import/eksportit + tregtarë të tjerë të kualifikuar – rreth 1,6 Gwh;
- volumet CFD (nga KESH-i) – rreth 2,03 GWh.



ANEKSI 2
PLANI I VEPRIMIT PËR KRIJIMIN E
BSHE-së

1. Këshilli i Ministrave, nëpërmjet këtij vendimi, autorizon MEI-n dhe OST sh.a. për marrjen e masave dhe përgatitjen e akteve të nevojshme për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë (BSHE).

2. Në përputhje me pikën 3.5, të modelit të tregut, BSHE-ja do të jetë një person juridik, i cili do të krijohet sipas legjislacionit shqiptar, përgjegjës për funksionimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike.

3. BSHE-ja do të kryejë funksionet e përcaktuara në pikën 3.5, të modelit të tregut dhe, fillimisht, ndër të tjera, do të kryejë grumbullimin e ofertave nga ana e pjesëmarrësve të tregut, si dhe përputhjen dhe likuidimin e produkteve me shumicë të energjisë elektrike mbi baza orare. Likuidimi i kontratave, për një periudhë ndërmjetëse, do të menaxhohet nga një ofrues shërbimi, për llogari të BSHE-së. Produktet e tregtueshme në BSHE do të zhvillohen gradualisht, bazuar në nevojën e pjesëmarrësve të tregut, në mënyrë që të lejojë balancimin e portofolave të tyre përkatësisht për prodhimin, konsumin, importin dhe eksportin, si dhe për t'u integruar më mirë në tregun me shumicë evropian.

4. Aktivitetet për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike, si produkt fizik, do të mund të kryhen nga gjithë pjesëmarrësit e tregut të regjistruar në BSHE, pa u kufizuar nga një detyrim i shërbimit publik, në përputhje me modelin e tregut dhe ligjin për sektorin e energjisë elektrike.

5. Procesi i krijimit dhe i përcaktimit të strukturës së pronësisë së BSHE-së do të drejtohet nga ministri përgjegjës për energjinë, në përputhje me këtë plan:

a) Deri më 1 shtator 2016, ministri përgjegjës për energjinë do të ngrejë, zyrtarisht, një njësi pranë OST sh.a., që do të shërbejë në një hap të mëvonshëm si bërthama e strukturës së BSHE-së. Kjo njësi raporton periodikisht te ministri për çdo detyrë të ngarkuar nga urdhri i ministrit dhe ky model tregu. Kjo njësi do të përgatisë bazën ligjore të nevojshme për krijimin e BSHE-së dhe dokumentacionin e nevojshëm, për aplikimin për

licencë për BSHE-në në ERE. Kjo njësi do të përgatisë marrëveshjet e bashkëpunimit me kompanitë partnere dhe mund të shikojë mundësinë për të marrë pjesë në projekte rajonale dhe evropiane për bashkimin e tregjeve;

b) Brenda datës 31 dhjetor 2016, njësia e ngritur do t'i propozojë ministrit të energjisë dhe industrisë strukturën organizative të shoqërisë, bazën ligjore të nevojshme si dhe gjithë dokumentacionin përkatës, për ngritjen dhe funksionimin e BSHE-së;

c) Ministri vendos për krijimin e personit juridik dhe strukturën përkatëse brenda datës 31 mars 2017. OST-ja do të kërkojë ofrues shërbimesh me eksperiencë ndërkombëtare, të interesuar për t'u bërë aksionarë të mundshëm në BSHE dhe, në të njëjtën kohë, për të siguruar pjesën më të madhe të shërbimeve operacionale për shoqërinë. Këto shërbime duhet të mbulojnë, së paku, por pa u kufizuar në, mbledhjen e ofertave të pjesëmarrësve të tregut, përputhjen e ofertave, përlllogaritjen e marzhet e tregtimit për pjesëmarrësit e tregut, bazuar në skema garantuese/kolaterale të miratuara, si dhe plotësimin e gjitha detyrimeve për raportim dhe publikim. Fillimisht ofruesi i shërbimeve do të drejtojë, gjithashtu, proceset që lidhen me shlyerjen dhe pagesën e pjesëmarrësve të tregut, duke përfshirë faturimin dhe arkëtimin. BSHE-ja do marrë gradualisht përgjegjësinë për faturimin dhe arkëtimin;

ç) BSHE-ja, nëse kërkohet dhe miratohet nga aksionarët fillestarë, do të jetë e hapur për pronarët e tjerë në shoqëri;

d) Procedura e krijimit dhe struktura e pronësisë së BSHE-së do të marrë parasysh praktikat më të mira në Bashkimin Evropian dhe Komunitetin e Energjisë dhe, nga ana tjetër, do të promovojë cilësinë dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve, do të përmirësojë reputacionin e Shqipërisë si vend tregtues dhe do të sigurojë qëndrueshmëri financiare afatgjatë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë do të mbështesë BSHE-në, si dhe autoritetet e tjera dhe pjesëmarrësit e tregut, në këtë drejtim;

dh) Ministri përgjegjës për energjinë do të shikojë mundësinë për përfshirjen e OST-ve të tjera në strukturën e pronësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe sipas një procedure standarde për pranimin e aksionarëve të rinj, që



do të detajohet në statutin e shoqërisë. Në statut do të parashikohet që të gjitha OST-ve fqinje, të licencuara dhe që shprehin vullnetin e tyre për t'u bashkuar me strukturën e aksionarëve të BSHE-së, do t'u jepet mundësia për t'u bërë aksionar, mbi baza të barabarta me të gjithë OST-të e mëparshme;

e) Në datën 30 qershor 2017, BSHE-ja do jetë gati për fillimin e operacioneve të tregut shqiptar të energjisë, në përputhje me këtë model tregu.

6. Pas themelimit të saj, BSHE-ja mund të bëhet palë nënshkruese e Memorandumit të Mirëkuptimit të Ballkanit Perëndimor 6, për Zhvillimin e Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike dhe krijimin e një kuadri për bashkëpunime të tjera në të ardhmen, dhe të marrë të gjitha të drejtat e përgjegjësitë që rezultojnë prej tij. Ky proces do të mbështesë integrimin e tregut shqiptar të energjisë elektrike të ditës në avancë, në atë rajonal dhe evropian.

7. Deri më 31 dhjetor 2017, ministri përgjegjës për energjinë do të marrë vendimin për fillimin operacional të Bursës Shqiptare të Energjisë, bazuar në përmbushjen e hapave ligjorë, teknikë dhe rregullatorë, të përshkruar më sipër, për implementimin e Modelit Shqiptar të Tregut.

8. Ministri përgjegjës për energjinë bashkëpunon me ERE-n si dhe me ministrinë dhe institucionet e tjera publike për krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë. Ministria do të koordinojë hapat e nevojshëm edhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, IFC-në dhe institucionet e tjera ndërkombëtare financiare.

VENDIM

Nr. 520, datë 13.7.2016

**PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHITESA NË VENDIMIN NR. 325, DATË
19.3.2008, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
RREGULLAVE PËR PRANIMIN NË
VEPRIMTARINË E OPERATORIT TË
TRANSPORTIT RRUGOR TË
MALLRAVE DHE TË UDHËTARËVE, SI
DHE PËR NJOHJEN E
DOKUMENTEVE ZYRTARE, TË
CAKTUARA PËR KËTA OPERATORË”,
TË NDRYSHUAR²³**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 43, të ligjit nr.8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, dhe neneve 83 e 87, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregulloren që i bashkëlidhet vendimit nr. 325, datë 19.3.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

I. Në kapitullin II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Shkronja “b”, në pikën 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“b) të ketë qëndrueshmërinë e duhur financiare;”.

2. Pas shkronjës “c”, në pikën 1, shtohet shkronja “ç” me këtë përmbajtje:

“ç) të ketë vendosje efektive dhe të qëndrueshme në Shqipëri.”.

3. Shkronja “c”, në pikën 2.2, riformulohet si më poshtë vijon:

²³ Ky vendim është i përafruar me rregulloren (KE) nr. 1071/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 21 tetor 2009, “Mbi vendosjen e rregullave të përbashkëta në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen për ushtrimin e profesionit të operatorit të transportit rrugor, e cila shfuqizon direktivën e Këshillit 96/26/KE”, nr. CELEX 32009R1071, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian L300, 14.11.2009, faqe 51–71.



“c) me aftësinë e tij si drejtues veprimtarie, personi i përmendur sipas shkronjës “a” të kësaj pike, lejohet të drejtojë veprimtarinë e transportit deri në 3 (tri) ndërmarrje të ndryshme, me një numër të përgjithshëm maksimal të mjeteve motorike dhe/ose kombinimit të mjeteve, prej 36 mjetesh.”.

4. Pika 2.3 riformulohet si më poshtë vijon:

“2.3 Drejtuesi i veprimtarisë, i caktuar në përputhje me pikën 2.1 të këtij kapitulli, mund të caktohet në përputhje me shkronjën “c”, të pikës 2.2, të këtij kapitulli, edhe në një ndërmarrje ose filial tjetër, përveç asaj të përmendur në pikën 2.1, të këtij kapitulli, veprimtaritë e të cilave kryhen me një numër të përgjithshëm maksimal të mjeteve motorike dhe/ose kombinimit të mjeteve, prej 30 mjetesh.”.

5. Pas pikës 3.5 shtohet pika 3.5.1, me këtë përmbajtje:

“3.5.1 Operatori i transportit informon me shkrim organin e transportit të lëshimit të licencës për ndonjë dënim të vendosur ndaj tij ose të ndonjë personi të përmendur në pikën 2.1 dhe në shkronjën “a”, të pikës 2.2, të këtij kapitulli, brenda 28 ditëve, nga dita që ka marrë dënimin ose nga dita që e ka apeluar dënimin.”.

6. Shkronja “a”, në pikën 4.1, riformulohet si më poshtë vijon:

“a) 2-vjeçare, për shkelje të nënplikave të shkronjës “a”, të pikës 3.1, me përjashtim të nënplikave “xi” dhe “xv”;

7. Titulli i pikës 5 riformulohet si më poshtë vijon:

“5. Plotësimi i kushtit për qëndrueshmërinë e duhur financiare”.

8. Shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 5.2, riformulohen me këtë përmbajtje:

“a) 7 200 euro, për mjetin e parë, dhe 4 000 euro për çdo mjet shtesë, të autorizuar për t'u përdorur në transportin ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve;

b) 140 000 lekë, për mjetin e parë, dhe 70 000 lekë për çdo mjet shtesë, të përdorur kur kryen transport të mallrave e të udhëtarëve brenda vendit.”.

9. Pika 5.4 riformulohet me këtë përmbajtje:

“5.4 Kushti, në lidhje me kapitalin minimal të vlefshëm dhe rezervë të qëndrueshmërisë financiare, të veprimtarisë së ndërmarrjes në transportin rrugor ndërkombëtar dhe brenda

vendit të mallrave dhe udhëtarëve, i përcaktuar sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5.2, do të arrihet një vit nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.”.

10. Pika 6.4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“6.4 Kualifikimi dhe trajnimi periodik i kandidatëve që kërkojnë të pajisen me certifikatën e kompetencës profesionale (CKP) për drejtues veprimtarie të ndërmarrjeve të transportit rrugor zhvillohet në qendrat e trajnimit, të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin.

6.4.1 Qendër trajnimi nënkupton një person, entitet ose organizatë, e miratuar për zhvillimin e kurseve të trajnimit profesional të kandidatëve që dëshirojnë të pajisen me certifikatën e kompetencës profesionale për drejtues veprimtarie në transportin rrugor dhe në përputhje me kërkesat e rregulloreve evropiane përkatëse, organizmave ndërkombëtare të transportit, si dhe kërkesat e legjislacionit shqiptar.

6.4.2 Kushtet bazë të pranimit si qendër trajnimi janë:

a) Reputacioni i mirë i drejtuesit të veprimtarisë së qendrës, drejtuesve të programeve dhe instruktorëve, sipas pikës 3, të kapitullit II, të kësaj rregulloreje;

b) Plotësimi i kushteve të mjaftueshme për mjedisin, infrastrukturën dhe bazën didaktike;

c) Kompetenca profesionale e stafit të qendrës së trajnimit, në përputhje me programin e trajnimit;

ç) Programet e trajnimit, të miratuara nga ministri përgjegjës për transportin.

6.4.3 Kriteret që duhet të përmbushë qendra e trajnimit, kërkesat që duhet të plotësojnë instruktorët e trajnimit si dhe verifikimi në vazhdimësi i përmbushjes së këtyre kriterëve nga qendra e trajnimit, e miratuar, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për transportin.

6.4.4 Modeli i certifikatës së kompetencës profesionale (CKP) për drejtues veprimtarie të ndërmarrjeve të transportit rrugor miratohet nga ministri përgjegjës për transportin, në përputhje me rregulloren evropiane përkatëse dhe organizmat ndërkombëtare, ku bën pjesë Republika e Shqipërisë.”.

11. Pika 6.5 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“6.5 Me qëllim përditësimin e njohurive në fushën e transportit, drejtuesit e veprimtarisë



kryejnë trajnimin e reduktuar, pasi janë plotësuar 5 vjet nga lëshimi i certifikatës së kompetencës profesionale që ata zotërojnë.

6.5.1 Qendra e trajnimit e autorizuar harton programe të veçanta për trajnimin e reduktuar, që burojnë nga programi bazë. Kandidati duhet të aplikojë, të paktën, 2 muaj para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së certifikatës. Tarifat për trajnim caktohen në udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për transportin dhe ministrit të Financave.”.

12. Pika 7.2 riformulohet si më poshtë vijon:

“7.2 Komisioni i vlerësimit të provimit, sipas pikës 7.1, emërohet nga ministri përgjegjës për transportin dhe përbëhet nga kryetari dhe dy anëtarë. Kryetari dhe anëtarët e komisionit duhet të jenë persona me integritet të lartë moral e profesional në fushën e transportit. Anëtarët e komisionit duhet të jenë të pajisur me diploma të shkollave të larta, të përmendura në pikën 8.1 të këtij kapitulli.”.

13. Pika 7.3 shfuqizohet.

14. Pika 7.4 riformulohet si më poshtë vijon:

“Provimi i kandidatëve zhvillohet në një nga ambientet e qendrave të trajnimit, të miratuara.”.

15. Pika 8.4 riformulohet si më poshtë vijon:

“8.4 Organet e transportit dhe ose QKL-ja do të pranojnë si provë të mjaftueshme të kompetencës profesionale një certifikatë që përputhet me certifikatën model, të përcaktuar në shtojcën III, të rregullores evropiane 1071/2009, dhe që lëshohet nga autoriteti ose organi i autorizuar për këtë qëllim nga shteti anëtar i BE-së.”.

16. Pas pikës 8 shtohet pika 9, me këtë përmbajtje:

“9. Kushtet në lidhje me kërkesën e vendosjes.

Për plotësimin e kërkesave të shkronjës “d”, të pikës 1, ndërmarrja e transportit duhet:

a) të jetë e vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, me ambiente në të cilat ajo mban dokumentet kryesore të biznesit, në veçanti dokumentet e kontabilitetit, të personelit, dokumentet që përmbajnë të dhëna në lidhje me orët e drejtuesve të mjeteve dhe ndonjë dokument tjetër, tek i cili autoriteti përgjegjës duhet të ketë akses, me qëllim verifikimin e përputhjes me kushtet e vendosura në këtë rregullore;

b) pas marrjes së licencës, të ketë në dispozicion të saj një ose më shumë mjete rrugore të vëna në qarkullim, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të regjistruara, qofshin në pronësi, me kontrata blerjeje me këste ose me qira;

c) të drejtojë efektivisht dhe në vazhdimësi, me pajisje administrative të nevojshme, operacionet e saj në lidhje me mjetet e përmendura në shkronjën “b” të kësaj pike, në një qendër operative të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

II. Në kapitullin IV bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1.1 e këtij kapitulli, riformulohet si më poshtë vijon:

“1.1 Në zbatim të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, krijohet regjistri elektronik kombëtar për ndërmarrjet e transportit rrugor. Regjistri përmban të dhënat lidhur me drejtuesit e veprimtarisë së transportit, drejtuesit e mjeteve, licencat dhe dokumentet e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë për të gjithë operatorët e transportit rrugor.”.

2. Pika 1.2 riformulohet si më poshtë vijon:

“1.2 Regjistri elektronik kombëtar vendoset në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Të dhënat që përmban regjistri elektronik kombëtar trajtohen dhe mbikëqyren vetëm nga personat përgjegjës, të caktuar për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

3. Pika 1.3 riformulohet, me këtë përmbajtje:

“1.3 Të gjitha ndërmarrjet e transportit rrugor, të vendosura në Shqipëri, janë të detyruara të regjistrohen në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor.

Pas licencimit të subjektit transportues, organi që e ka licencuar atë dërgon informacion te mbajtësi i Regjistrit Elektronik Kombëtar të Transportit Rrugor për ndërmarrjen e transportit dhe çdo ndryshim që mund të ndodhë gjatë ushtrimit të veprimtarisë.”.

4. Pika 1.6 riformulohet, si më poshtë vijon:

“1.6. Të dhënat në lidhje me një ndërmarrje, së cilës i është pezulluar ose i është hequr licenca apo kur drejtuesi i veprimtarisë është deklaruar i papërshtatshëm, do të mbahen në regjistër për një periudhë dyvjeçare, nga data e pezullimit ose



e heqjes së licencës, dhe më pas do të fshihen menjëherë. Të dhënat duhet të shoqërohen në regjistrë me arsyet e heqjes së licencës ose deklarimin e papërshtatshmërisë së drejtuesit të veprimtarisë.”.

5. Pika 1.8 riformulohet si më poshtë vijon:

“1.8 Ministria përgjegjëse për transportin të marrë masat për ngritjen e regjistrit elektronik kombëtar deri më 1 janar 2017.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 521, datë 13.7.2016

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE
TË MJEKIMIT TË ZNJ. ERMIRA
BAKALLI (GARUNJA)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Ermira Bakalli (Garunja), në masën 3 300 000 (tre milionë e treqind mijë) lekë.

2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale, përkatëse, të institucionit të mjekimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM

Nr. 522, datë 13.7.2016

**PËR KRIJIMIN E BAZËS TË TË
DHËNAVE SHTETËRORE “SISTEMI I
MENAXHIMIT TË KARTELAVE
INFORMATIVE PËR SHËRBIMET
PUBLIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e bazës të të dhënave shtetërore “Sistemi i Menaxhimit të Kartelave Informative për Shërbimet Publike” (këtu e në vijim “SMKISHP”).

2. Institucioni administrues i SMKISHP-së është Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (këtu e në vijim “ADISA”).

3. Dhënës të informacionit për SMKISHP-në janë institucionet e administratës shtetërore që ofrojnë shërbimet publike ndaj personave fizikë dhe personave juridikë.

4. Të dhëna parësore konsiderohen të dhënat e grumbulluara nga vetë kjo bazë të dhënash, të cilat përfshijnë:

- a) emrin e shërbimit publik;
- b) kodin e shërbimit publik;
- c) klasifikimin e shërbimit publik sipas:
 - i) funksionit;
 - ii) grupit të shërbimeve;
 - ç) përshkrimin e shërbimit publik, i cili përmban:

i) kërkesat që duhen plotësuar për marrjen e shërbimit publik;

ii) mënyrën e marrjes së shërbimit publik;

iii) listën e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e shërbimit (emërtimi i dokumentit 1, emërtimi i dokumentit 2, emërtimi i dokumentit 3);

iv) informacion për dokumentin përfundimtar që vërteton marrjen e shërbimit publik;

v) afatin e vlefshmërisë së dokumentit përfundimtar që vërteton marrjen e shërbimit publik;

vi) përfituesit e shërbimit;

vii) kohën e marrjes së shërbimit publik;



viii) tarifën e shërbimit publik;
ix) informacion për mënyrën e trajtimit të ankesave;

d) datën e fundit të ndryshimeve;
dh) formularin e aplikimit për marrjen e shërbimit publik;

e) kanalet e ofrimit të shërbimit publik.

5. Të dhëna dytësore konsiderohen të dhënat që merren nga baza të tjera të dhënash, të cilat përfshijnë:

a) informacionin për organin kompetent që ofron shërbimin publik;

b) adresën e organit kompetent që ofron shërbimin publik;

c) shërbimet elektronike (këtu e në vijim “e-shërbimet”).

6. Baza e të dhënave të SMKISHP-së shkëmben informacion me institucionet publike, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, lidhur me shërbimet që ofrohen bazuar në legjislacionin nëpërmjet Platformës Qeveritare të Ndërveprimit.

7. Bazat e të dhënave shtetërore të institucioneve përkatëse, nga të cilat SMKISHP-ja merr të dhëna parësore, janë, si më poshtë vijon:

a) Departamenti i Administratës Publike, HRMIS, informacion për institucionet;

b) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, RKA, adresat e institucioneve;

c) Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e-Albania GG, e-shërbimet;

ç) Institucione të tjera, me të cilat SMKISHP-ja mund të ndërveprojë dhe që mund të ngarkohen me akte të tjera, ligjore e nënligjore.

8. Niveli i aksesit në bazën e të dhënave të SMKISHP-së është, si më poshtë vijon:

a) Subjektet e përcaktuara në pikën 3 kanë të drejtë vetëm të marrin informacion përmes kanaleve të komunikimit e të ndërveprimit lidhur me të dhënat parësore.

b) ADISA ka të drejta të plota administrative mbi bazën e të dhënave, në rolet:

i) administrator;

ii) raportues;

iii) auditues;

iv) aprovues;

v) lexues të informacionit.

c) Institucionet e tjera shtetërore, që ofrojnë shërbime publike ndaj subjekteve të përcaktuara në pikën 3, kanë të drejtë të lexojnë informacionin, të hedhin të dhënat apo të modifikojnë informacionin vetëm në lidhje me shërbimet publike respektive të institucionit përkatës, i cili më pas miratohet nga ADISA.

9. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i bazës të të dhënave të SMKISHP-së përcaktohen me rregullore të brendshme të institucionit administrues dhe miratohet nga drejtori Ekzekutiv i ADISA-s, në përputhje me rregullat e parashikuara në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazën e të dhënave shtetërore”.

10. Ngarkohet Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

URDHËR

Nr. 32/1, datë 14.7.2016

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME ME URDHRIN NR. 32, DATË 29.4.2014, “PËR MIRATIMIN E MODELIT TË KARTËS SË INSPEKTORIT”

Në zbatim të nenit 30, pika 4, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Në modelin e kartës së inspektorit, të miratuar me urdhrin nr. 32, datë 29.4.2014, të bëhen edhe këto shtesa e ndryshime:

- Në pjesën e përparme të kartës së inspektorit, të ndryshohen:

- stema e Republikës (në mes të kartës);

- REPUBLIKA E SHQIPËRISË (në mes të kartës);

- emri i inspektoratit shtetëror (në mes të kartës).

- Në pjesën e prapme të kartës së inspektorit, të shtohet:

- emër, mbiemër i inspektorit të përgjithshëm;

- nënshkrimi i inspektorit të përgjithshëm;



- vula e institucionit.

2. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe inspektoratet shtetërore/trupat e tjerë inspektues, për zbatimin e këtij urdhri.

3. Ky urdhër dërgohet për Botim në Fletoren Zyrtare publikohet në faqen zyrtare të inspektoratit qendror, www.inspektoratiqendror.gov.al, dhe i

njoftohet inspektorateve shtetërore/trupave inspektues.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim Hajdari

KARTA INSPEKTOR

(Pjesa Para)


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
EMRI INSPEKTORATIT SHTETËROR

KARTË INSPEKTORI

Emër Mbiemër: Xxxxx XXXXXX
Pozicioni: **Inspektor i punës**
Kodi: **00001**

Data e lëshimit: **xx.xx.2016**

(Pjesa Mbrapa)


INSPEKTOR I PËRGJITHSHËM
Shkëlqim HAJDARI

Firma _____

Vula IO

Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj.
Në rast humbjeje ose moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni kartën pranë Inspektoratit Qendror.

info@insq.gov.al
www.inspektoratiqendror.gov.al

KARTA INSPEKTOR MODELI II

(Pjesa Para)


REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Logo
Inspektoratit
Shtetëror

KARTË INSPEKTORI

Emër Mbiemër: Xxxxx XXXXXX
Pozicioni: **Inspektor i punës**
Kodi: **00001**

Data e lëshimit: **xx.xx.2016**

(Pjesa Mbrapa)


SHKËLQIM HAJDARI
Inspektor i Përgjithshëm

Firma _____

Vula IO

Kjo kartë mund të përdoret vetëm nga mbajtësi i saj.
Në rast humbjeje ose moskthimi mbajtësit, lutemi dërgoni kartën pranë Inspektoratit Qendror.

info@insq.gov.al
www.inspektoratiqendror.gov.al

**VENDIM***(i shkurtuar)*

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 1076, datë 7.6.2016, vendosi shpalljen e zhdukur të shtetasit Veteran Nevrus Avxhi, i datëlindjes 5.4.1943 dhe caktimin e shtetases Donika Liko Lake, e datëlindjes 18.7.1961, si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 308 lekë